

ISSAI 5220

UDHËZIME MBI PRAKTIKAT
MË TË MIRA TË AUDITIMIT
TË FINANCIMIT PRIVAT/PUBLIK
DHE KONCESIONEVE

Kodi i Transparencës Fiskale





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ISSAI 5220

**UDHËZIME MBI PRAKTIKAT MË TË MIRA TË AUDITIMIT
TË FINANCIMIT PRIVAT/PUBLIK DHE KONCESIONEVE**



Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI, publikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI.

Për më shumë informacione, vizitoni www.issai.org

&



**Kodi i
Transparencës
Fiskale**

Tiranë, 2014

Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t – RECHNUNGSHOF

(Gjykata Austriake e Auditit)


DAMPFSCHIFFSTRASSE 2

A-1033 VIENNA

AUSTRIA

Tel.: ++43 (1) 711 71 • Fax: ++43 (1) 718 09 69

ISSAI 5220



E-MAIL: intosai@rechnungshof.gv.at;

WEB: <http://www.intosai.org>

Titujt në origjinal:
*ISSAI 5220 "Guidelines on Best Practice for the Audit of Public/Private Finance and
Concessions",
Fiscal Transparency Code, IMF
EUROSAI, VI Congres, June 2005, "Publik Income Auditing" , conclusion and
recomandations*

Titulli:
ISSAI 5220,
Udhëzime mbi praktikat më të mira të auditimit
të financimit privat/publik dhe koncesioneve
&
Kodi i Transparencës Fiskale, FMN

Materiali u përkthye dhe u përgatit për botim nga :

Dr. Edvin Stefani

Albana Agolli

Valentina Golemi

Yrjada Jahja

nën drejtimin e Dr. Bujar Leskaj

Art Design: Elisa Metaj

ISBN: 978-9928-159-24-3

Seria : botime KLSH - 11/2014/32

Shtypur në Shtypshkronjën " Mirgeeralb"
Tiranë 2014

Parathënie

Në koherencë me Programin e BE-së të Mbështetjes së Buxhetit për Përmirësimin e Menaxhimit të Financave Publike dhe me reformat e kërkuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, në vendin tonë është kryer një progres i konsiderueshëm, ku një arritje të spikatur e përbën rritja e rolit të auditimit të jashtëm publik, me miratimin nga Kuvendi të Ligjit të ri organik për KLSH-në më 27 Nëntor 2014. Me fitimin e statusit të vendit kandidat dhe rritjen e fluksit të financimit nga Bashkimi Evropian për Shqipërinë, bëhet i domosdoshëm shtimi i efektshmërisë dhe cilësisë së auditimit të financimeve me pjesëmarrjen e fondeve publike dhe private (partneriteti privat/publik) dhe të koncesioneve, nga ana e institucionit suprem të auditimit (KLSH).

Për të plotësuar këtë domosdoshmëri dhe në linjë me botimet e KLSH-së në vitet 2012, 2013 dhe 2014, i paraqesim lexuesit në një botim të përbashkët Standartin ISSAI 5520 *“Udhëzime mbi praktikën më të mirë të auditimit të financimit privat/publik dhe koncesioneve”*, Konkluzionet e Kongresit të VI të EUROSAT-t, viti 2005, mbi *“Auditimin e të Ardhurave Publike”* si dhe *Kodin e Transparencës Fiskale* të FMN-së.

Standarti ISSAI 5220 *“Mbi praktikën më të mirë të auditimit të financimit privat/publik dhe koncesioneve”* është një produkt i Grupit të Punës, INCOSAI XVI, 1998. Qasja e re e financimit publik/privat dhe e koncesioneve përfaqëson një hap përpara nga prokurimi tradicional i aseteve, ku sektori publik paguan për ndërtimin ose zhvillimin e një aseti dhe më pas lidh kontrata të tjera për mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe funksionimin e këtij aseti. Qasja e re është gjithashtu e ndryshme nga prokurimi tradicional, i cili përfshin vetëm dispozita parashikuese të shërbimeve. Në vend të kësaj, qasja e re e financimit publik/privat dhe e koncesioneve, përfshin ofrimin e shërbimeve në sektorin publik nga sektori privat, i cili merr gjithashtu përgjegjësinë për ndërtimin/zhvillimin dhe financimin e çdo aseti që nevojitet për ofrimin e shërbimit të kërkuar. Gjithashtu, shërbimet e ofruara mund të shtrihen përtej shërbimeve mbështetëse, të cilat tradicionalisht sektori privat ka ofruar për sektorin

publik, si mirëmbajtjet e ndërtesave, të shërbimeve, ofrimi i të cilave në të kaluarën ka qenë përgjegjësi e sektorit publik, të tilla si sigurimi dhe menaxhimi i burgeve, spitaleve dhe shkollave.

Qëllimi i këtij udhëzimi është të ofrojë një kornizë të plotë ligjore për ato institucione supreme auditimi(SAI) që do të duan të auditojnë këto marrëveshje, për të vendosur nëse sektori publik ka bërë marrëveshjen më të mirë të mundshme për taksapaguesit, duke rritur vlerën e parasë së taksapaguesve. Në funksion të këtij udhëzimi jepen 43 udhëzime të ndara në gjashtë seksione, që detajojnë mënyrën e auditimit të financimeve publik/privat dhe të koncesioneve.

Së dyti në këtë material është përfshirë përkthimi i *Kodit të Transparencës Fiskale*, Gusht 2014, i Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në standartin e paraqitur nga ky kod kërkohet nga Audituesi Suprem i Jashtëm që të vlerësojë besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe të dhënave fiskale të qeverive. Parimet e administrimit fiskal mbi të cilat ky Kod është bazuar janë:

- a. Raportimi Fiskal, ku kërkohet që raportet fiskale duhet të sigurojnë një pamje të besueshme, në kohë, të rëndësishëm dhe gjithëpërfshirëse të performancës e të pozicionit financiar të qeverisë.
- b. Parashikimin Fiskal dhe Buxhetimi, ku kërkohet që buxhetet dhe parashikimet fiskale të tyre duhet të sigurojnë një paraqitje të saktë të objektivave buxhetore dhe qëllimet e politikave të qeverisë dhe të jenë një projeksion i besueshëm, në kohë dhe gjithëpërfshirës i evolucionit të financave publike.
- c. Analiza e Riskut Fiskal dhe Menaxhimi, ku kërkohet nga Qeveritë që të bëjnë të ditur, të analizojnë dhe menaxhojnë riskun e financave publike dhe të sigurojnë koordinim efektiv të vendim marrjes fiskale për të gjithë sektorin publik. Secili parim sqarohet në tre nivele implementimi, në atë të Thjeshtë, të Mirë dhe në rastin e Avancuar.

Në të tre skenarët e parashikuar nga ky kod, ai i Thjeshtë, i Mirë dhe i Avancuar, Audituesi Suprem i Jashtëm duhet të auditojë në mënyrë të plotë raportimet fiskale qeveritare dhe pasqyrat financiare të qeverisë, duke dhënë një opinion mbi besueshmërinë e tyre. Në skenarin më të avancuar, nga Audituesi Suprem kërkohet


të publikohet raporti i tij i auditimit mbi besueshmërinë e të dhënave fiskale dhe financiare, bazuar në Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI-t).

Pika 2.4 e Kodit, lidhur me kredibilitetin e parashikimit fiskal dhe buxhetimit, kërkon që *“Parashikimet ekonomike dhe fiskale të qeverisë dhe performanca e saj të jenë subjekt i vlerësimit të pavarur”*, duke nënkuptuar një theksim të mëtejshëm të rolit të audituesit të jashtëm të pavarur, si faktor përcaktues në rritjen e transparencës fiskale, duke informuar publikun për performancën e qeverisë, jo vetëm përmes raportimit të Ministrit të Financave dhe qeverisë, por dhe përmes raportimit të audituesit të jashtëm të shtetit.

Në këtë botim përfshihet edhe Deklarata Përfundimtare e Kongresit të VI të EUROSAT të mbajtur në Bon nga data 30 Maj - 2 Qershor 2005, i cili trajtoi *“Auditimin e të Ardhurave Publike”* nga SAI-t. Kongresi i VI i EUROSAT-t, mori në konsideratë në mënyrë të detajuar një gamë çështjesh të rëndësishme dhe komplekse në shumë vende Europiane lidhur me punë e SAI-ve dhe rolin e tyre në financat publike. Kongresi rekomandoi që anëtarët e EUROSAT-t të inkurajohen që të rivlerësojnë strategjitë e tyre të përgjithshme për auditimin e të ardhurave, të ketë një auditim të koordinuar të subvencioneve të taksave që është i hapur për të gjithë anëtarët EUROSAT-t, dhe së fundi u shtrua domosdoshmëria e rritjes së rolit të auditimit të IT në auditimin e mashtimit me të ardhurat publike. Ky konkluzion është në përputhje me Deklaratën e Limës, Miratuar në Kongresin e IX-të të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) më 1977. Deklarata thekson domosdoshmërinë e rritjes së rolit të institucioneve supreme të auditimit si një bazë për sigurimin e transparencës përmes rezultateve objektive dhe të pavarura të auditimeve. Në nenin 20 të saj mbi *“Kontrollin Tatimor”* shprehet se *“Institucionet Supreme të Auditimit, kanë të drejtë të auditojnë mbledhjen e taksave dhe të shqyrtojnë dosjet individuale tatimore”* dhe *“Kontrollet tatimore janë kryesisht auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, megjithatë, në zbatim të ligjeve tatimore, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të shqyrtojnë edhe sistemin dhe efikasitetin e mbledhjes së taksave, arritjen e objektivave të të ardhurave dhe sipas rastit, të propozojnë përmirësime në organin legjislativ. Gjithashtu në nenin 23 “Sipërmarrjet Komerciale me Pjesëmarrjen e Publikut”, auditimi i financimeve publik/privat dhe koncesioneve duhet të fokusohet në çështjet e ekonomisë, eficiencës dhe*

efektivitetit, duke respektuar kufizimet e nevojshme për mbrojtjen e sekreteve industriale dhe tregtare.

Realizojmë publikimin në shqip të këtyre standardeve të auditimit dhe të vlerësimit, me besimin e plotë se botimi do t'i shërbejë rritjes së cilësisë së punës audituese në KLSH, duke shtuar rolin dhe kontributin e institucionit në mirëadministrimin e financave publike, në dy shtyllat e saj: krijimin e të ardhurave publike dhe përdorimin e tyre. Mendojmë se një auditim i plotë i krijimit dhe përdorimit të vlerave publike rrit transparencën dhe rrit vlerën e parasë publike. Sipas konkluzioneve të studimeve të kryera nga FMN ekziston një lidhje pozitive ndërmjet transparencës dhe performancës fiskale. Sipas studimit *“Fiscal Transparency, Fiscal Performance and Credit Ratings”*, 2012, kjo lidhje është më e fortë në vendet në zhvillim se sa në vendet e zhvilluara. Indeksi ROSC (Reports on the Observance of Standards and Codes), që zhvillohet nga FMN, shpreh nivelin e transparencës fiskale të një vendi. Vihet re një korrelacion pozitiv mes indeksit të transparencës fiskale dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto për Frymë si dhe përmirësim të raportit borxh publik/PBB:



Grafiku tregon për një rritje të PBB-së për frymë me rritjen e indeksit ROSC, që mat transparencën fiskale. Sipas studimit rritja e transparencës rrit performancën e organeve fiskale dhe ul korrupsionin duke rritur mbledhjen e të ardhurave tatimore.

Botimi i kodit të transparencës së FMN-së dhe Deklarata e Kongresit të VI të EUROSAI shërbejnë si referencë e plotë për të rritur cilësinë e punës sonë audituese në drejtim të shtimit të transparencës, me efekt rritjen e vlerës së parasë publike të mbledhur nga organet fiskale. Zbatimi i standardit ISSAI 5520 ngre nivelin profesional të auditimit, në drejtim të mirëpërdorimit të kësaj paraje publike.

Si KLSH, jemi të përkushtuar që auditimi i organeve fiskale, financimeve privat/publik dhe koncesioneve të jetë sa më cilësor, profesional dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, me qëllim që të jemi në gjendje të përcaktojmë me vërtetësi dhe plotësi performancën e punës së punonjësit të Shtetit, duke dhënë rekomandimet tona për përmirësimin e kësaj performance.

Bujar LESKAJ



ISSAI 5220

Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI, të publikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI. Për më shumë informacion vizitoni www.issai.org

INTOSAI



**UDHËZIME MBI
PRAKTIKAT MË TË
MIRA TË AUDITIMIT
TË FINANCIMIT
PRIVAT/PUBLIK
DHE
KONCESIONEVE**

PËRMBAJTJE		Faqe
1	Përmbledhje	15
	Seksioni 1: Qasja e përgjithshme e SAI-t	24
	Seksioni 2: Studimi i projektit	31
	Seksioni 3: Menaxhimi i projekteve	45
	Seksioni 4: Tenderimi	58
	Seksioni 5: Kontrata e Duhur	62
	Seksioni 6: Faza operationale	68
	Fjalor	75
2	Kodi i Transparencës Fiskale	79
	A-Parimet e Transparencës Fiskale Raportimi fiskal	79
	Parashikimi Fiskal dhe Buxhetimi	80
	Analiza e Riskut Fiskal dhe Menaxhimi	82
	Tabelat	85
	B. Përshkrim në Princim i Praktikave Bazike, të Mira dhe të Avancuara	
3	Auditimi i të Ardhurave Publike Konkluzione dhe Rekomandime	97
	Rëndësia e të Ardhurave Publike për Menaxherët Financiarë Publikë dhe për Autoritetin buxhetor Legjislativ	99
	Roli i SAI-t në Ciklin Buxhetor	102
	Metodat e Auditimit dhe Ndikimi i Auditimit	105
	Rekomandime të përgjithshme	107

Përmbledhje

Në zbatim të vendimit të marrë nga INCOSAI XIV në Uashington në vitin 1992, u krijua Grupi i Punës INTOSAI mbi Auditimin e Privatizimit nga Bordi Drejtues në Maj të vitit 1993 nën kryesinë e Sir John Bourn, shef i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar. Që prej themelimit, Grupi i Punës u fokusua në auditimin e ligjshmërisë ekonomike dhe Bashkëpunimeve Publike e Private.¹

Grupi i Punës përbëhet nga përfaqësues të SAI -ve nga 42 vendet e mëposhtme:

Shqipëria	Estonia	Paraguaj
Antigua dhe Barbuda	Franca	Peru
Argjentina	Gjermania	Polonia
Australia	Hungaria	Romania
Austria	India	Federata Ruse
Bahamas	Izraeli	Arabia Saudite
Bangladesh	Letonia	Slovakia
Brazil	Lituania	Slovenia
Bullgaria	Meksika	Turqi
Kili	Maroku	Mbretëria e Bashkuar (Kryesuese)
Republika Çeke	Zelanda e Re	Uruguaj
Ekuador	Norvegjia	Venezuela
Egjipt	Oman	Jemen
El Salvador	Papua Guinea e Re	Zambia

Vitet e fundit Qeveritë kanë eksperimentuar një larmi mënyrash me anë të të cilave sektori privat dhe ai shtetëror mund të bashkëpunojnë për të përfutur vlerë më të mirë për paratë e taksapaguesve në ofrimin e shërbimeve publike. Përfitimet vijnë

¹ Paketa e plotë e udhëzimeve përfshin praktikat më të mira të auditimit të Privatizimeve, auditimin e Rregullaritetit Financiar dhe auditimin e Financave Publike e Private. Këto udhëzime mund të gjenden në faqen e internetit të Grupit të Punës së Privatizimeve <http://www.nao.org.uk/INTOSAI/wgap/home.htm>

nga krijimi i një strukture ku vlera e parasë optimizohet, nëpërmjet inovacioneve në sektorin financiar privat dhe aftësive menaxhuese; nëpërmjet sinergjive nga lidhja e projektimit, ndërtimit dhe operimit; përmes ndërtimit inxhinierik; nëpërmjet shpërndarjes efektive të riskut dhe nëpërmjet qasjes së vazhdueshme për ofrimin e shërbimeve.

Në vitin 1998, INCOSAI XVI ftoi Grupin e Punës të zhvillojë udhëzimin mbi auditimin e rasteve më të mira të partneriteteve të tilla publik/privat, të financimit publik/privat dhe koncesioneve. Udhëzuesit përfundimtarë janë botuar në Tetor të vitit 2001, dhe që prej asaj kohe janë përdorur nga SAI-t të përfshira në auditime të këtyre kontratave. Në INCOSAI XVIII, në vitin 2004, rishikimi i punës së deritanishme të Grupit të Punës përfshiu kërkesat për të rregulluar udhëzimet ekzistuese nën dritën e përvojës. Në takimin vjetor të Grupit të Punës, në Londër në vitin 2006, anëtarët u fokusuan në rishikimin e udhëzuesve të financimit publik/privat dhe të koncesioneve për XIX INCOSAI në vitin 2007.

Qasja e re e financimit publik/privat dhe e koncesioneve përfaqëson një hap përpara nga prokurimi tradicional i aseteve, ku sektori publik paguan për ndërtimin ose zhvillimin e një aseti dhe më pas lidh kontrata të tjera për mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe funksionimin e këtij aseti. Qasja e re është gjithashtu e ndryshme nga prokurimi tradicional, i cili përfshin vetëm dispozita parashikuese të shërbimeve. Në vend të kësaj, qasja e re e financimit publik/privat dhe e koncesioneve, përfshin ofrimin e shërbimeve në sektorin publik nga sektori privat, i cili merr gjithashtu përgjegjësinë për ndërtimin/zhvillimin dhe financimin e çdo aseti që nevojitet për ofrimin e shërbimit të kërkuar. Gjithashtu, shërbimet e ofruara mund të shtrihen përtej shërbimeve mbështetëse, të cilat tradicionalisht sektori privat ka ofruar për sektorin publik, si mirëmbajtjet e ndërtesave, të shërbimeve, ofrimi i të cilave në të kaluarën ka qenë përgjegjësi e sektorit publik, të tilla si sigurimi dhe menaxhimi i burgjeve, spitaleve dhe shkollave.

Kështu, financimet publik/privat dhe kontratat koncesionare përfshijnë klientë të sektorit publik duke specifikuar shërbime të cilat ata dëshirojnë të blejnë, dhe nëpërmjet konkurrencës, përzgjedhin furnizuesit e sektorit privat. Në të kundërt, mund ti jepet me konçesion një furnizuesi të sektorit privat, i cili ngarkon me përgjegjësi publikun e përgjithshëm mbi përdorimin e shërbimeve të ofruara. Ndonjëherë sektori privat do të duhet të ndërtojë asete të reja fizike, të tilla si ndërtesa, për të ofruar shërbime të veçanta. Dhe ndonjëherë asetet ekzistuese të sektorit publik mund të transferohen ose të jepen me qera për furnizues të sektorit privat për të mundësuar furnizuesin të ofrojë shërbimet e kërkuara.

Siç u përmend më lart, kjo qasje për të ofruar shërbime, mund të sigurojë perspektiva për vlerë më të mirë për parane, se sa metodat tradicionale të financuara publikisht. Gjithsesi, si një metodë e re, është edhe më e komplikuar se metodat tradicionale dhe sjell me vete rrisht të reja për vlerësimin e parasë. E gjitha kjo do të thotë se sigurimi i përfitimeve të mundshme të qasjes së financimit publik/privat dhe të koncesioneve kërkon aftësi të reja në pjesën e sektorit publik.

Ndërkohë që qasja e financimit publik/privat dhe e koncesioneve është maturuar ekziston një numër në rritje i kontratave të cilat kanë hyrë në fazën operacionale. Në këtë mënyrë, fokusi i shqyrtimit të marrëveshjeve është zgjeruar nga çështjet që lindin, në prokurimin dhe negocimin e marrëveshjeve, për përfshirjen e çështjeve që lindin në jetëgjatësinë e kontratës. Në veçanti, këto përgjegjësi për menaxhimin e kontratave në zbatim, duhet të njohin rëndësinë e reagimit ndaj ndryshimeve. Kjo përfshin rritjen e elasticitetit në kontratë, për tu përshtatur me ndryshimet në teknologji dhe në shërbimet që mund të ofrohen dhe duke u siguruar që sektori publik të ruajë një ekip të aftë dhe me njohuri për të menaxhuar kontratën gjatë kohëzgjatjes së saj. Ekziston gjithashtu, nevoja për struktura të duhura qeverisëse; për rëndësinë e rishikimit të rregullt të vlerës së parasë; dhe për sigurimin se shpenzimet e kontratës janë regjistruar në mënyrën e duhur.

Qëllimi i udhëzimeve është të ofrojnë një kornizë ligjore për ato SAI që do të duan të auditojnë këto marrëveshje, për të vendosur nëse sektori publik ka bërë marrëveshjen me të mirë të mundshme për taksapaguesit. Udhëzimet synojnë të mbulojnë të gjitha çështjet e përfshira potencialisht në marrëveshje të tilla, ndonëse jo të gjitha udhëzimet do të kenë lidhje me çdo çështje ose një SAI nuk mund të ketë kompetencat e nevojshme për të ndjekur çdo udhëzues në mënyrë të plotë. Grupi i Punës pranon se qasja e re ndaj financimit publik/privat dhe ndaj koncesioneve do të jetë ende e re në disa vende dhe për këtë arsye edhe për disa SAI. Në anën tjetër, disa vende tashmë kanë disa vjet eksperiencë me këtë qasje në auditimin e koncesioneve, të cilat zhvillohen në përgjigje të një tregu të maturuar. Për këtë arsye, udhëzimet do të duhet të zbatohen në kushtet e një shteti. Asnjë nga çështjet e trajtuara në udhëzime nuk është e aplikueshme drejtpërdrejtë, të gjitha kërkojnë që SAI-t të jenë të informuar mirë dhe të balancuar në marrjen e vendimeve. për këtë arsye, çdo udhëzim është hartuar në një format të projektuar për të sjellë arsyetimin dhe përvojën. Për këtë qëllim, ka dy pjesë për çdo udhëzim:

- a) udhëzimi vetë; dhe
- b) arsyet për udhëzimin.

Udhëzimet: Përmbledhje

Këto udhëzime dhe udhëzimet plotësuese, duke dhënë më shumë këshilla të detajuara se si zbatohen udhëzimet, janë në dispozicion në faqen e internetit të Grupit të Punës www.nao.org.uk/INTOSAI/wgap.

Udhëzimet vetë janë grupuar në gjashtë seksione.

Seksioni 1: Qasja e përgjithshme e SAI-t

Nëse SAI funksionon për të kryer veprime të mirëmenduara nëpërmjet auditimeve të performancës, duke dhënë rekomandime të vlefshme dhe duke përhapur praktika të mira, atëherë duhet të përcaktojë rregullat e tij në ekzaminimin e financimit publik/privat dhe kontratave koncesionare, si dhe të planifikojë auditimin e tij tërësor. Do të ketë nevojë, gjithashtu, për qasje në aftësi të specializuara.

Udhëzimet

1. Përgjegjësitë e SAI-t
2. Përvetësimi i aftësive të nevojshme profesionale
3. Përfshirja e SAI-t.
4. Planifikimi i auditimit.

Seksioni 2: Studimi i projektit

Ky seksion trajton shqyrtimin e SAI-it, se si një organizatë prokuruese vendos mbi një marrëveshje koncesionare dhe financimi publik/privat. Gjatë shqyrtimit të kësaj teme, SAI do të duhet të ketë një kuptim të qartë, se si organizata zgjodhi këtë projekt në krahasim me alternativa të tjera të mundshme të investimit të burimeve të saj si dhe cilat ishin objektivat e saj. SAI do të duhet të shqyrtojë gjithashtu, se si organizata strukturoi projektin për të përmbushur nevojat e saj dhe se si ndikon në këtë strukturim vlerësimi i organizatës mbi kapacitetin e sektorit privat.

Udhëzimet

5. Përzgjedhja e projektit
6. Përcaktimi i kërkesave të projektit
7. Kapacitetet e sektorit privat

8. Vlerësimi i përfitimeve të mundshme
9. Objektivat e politikave të përgjithshme
10. Përzgjedhja e formave më të përshtatshme të partneritetit
11. Inovacioni
12. Vlerësimi i riskut
13. Përballeshmëria dhe vlera e mundshme e parasë
14. Përshkrimi i rastit të biznesit

Seksioni 3: Menaxhimi i projektit

Ky seksion trajton shqyrtimin e SAI-t se si një organizatë prokuruese menaxhoi procesin e dhënies së marrëveshjeve të financimit publik/privat dhe koncesionare. Kështu, SAI do të duhet të shqyrtojë nëse organizata ka ngritur një grup, me aftësitë profesionale dhe ekspertizën e nevojshme, me përgjegjësinë për ofrimin e projektit me sukses dhe nëse ka krijuar një sistem të duhur të kontrollit të kostos. SAI gjithashtu, do të duhet të shqyrtojë planifikimin që organizata ndërmorri për të siguruar se ka pasur një konkurrencë efektive për dhënien e kontratës dhe se çdo marrëveshje e rënë dakord ka shtuar vlerën e parasë.

Udhëzimet

15. Stafi i projektit
16. Hetimi i Tregut
17. Çështjet kontraktuale
18. Strategjia e tenderimit
19. Koha e Projektit
20. Krahasimi mes kostos dhe përfitimeve

21. Lista e tenderit
22. Specifikimet e kërkesave
23. Ruajtja e konkurrencës
24. Rishikime të rregullta
25. Buxhetet për kostot e projektit
26. Emërimi i këshilltarëve
27. Menaxhimi i kostos

Seksioni 4: Tenderimi

Ky seksion trajton shqyrtimin e SAI-it se si organizata prokuroese zgjodhi një partner të sektorit privat dhe më tej se si negocioi kontratën finale me të. SAI do të duhet të shqyrtojë a ka vlerësuar organizata në mënyrën e duhur të gjitha aspektet e ofertave të pranuar, të tilla si ndarjen e riskut mes vetes dhe sektorit privat, çmimin e kuotuar, dhe më pas a ka zgjedhur si ofrues të preferuar atë që ofroi vlerën më të mirë.

Udhëzimet

28. Propozimet e ofertuesve
29. Vlerësimi i ofertës
30. Zgjedhja e ofertuesit

Seksioni 5: Kontrata e duhur

Ky seksion mbulon shqyrtimin e SAI-t, se si organizata prokuroese fitoi siguri që marrëveshja ishte e duhura përpara angazhimit përmes nënshkrimit të kontratës.

SAI gjithashtu, do të ketë nevojë të rishikojë negociatat midis organizatës dhe tendetuesit të preferuar për të identifikuar efektet që çdo ndryshim në këto marrëveshje ka patur mbi vlerën e parasë. SAI gjithashtu do të duhet të kontrollojë faktin që marrëveshja ka arritur objektivat e saj, a është vlerësuar kundrejt të gjithë alternativave të mundshme, a është siguruar në mënyrë të përballeshme ofrimi i shërbimit dhe garancive përtej kontratës.

Udhëzimet

31. Ndryshimet gjatë negociatave me ofruesin fitues
32. Arritja e objektivave
33. Vlerësimi i alternativave
34. Sigurimi i ofrimit të shërbimit
35. Konfirmimi i mundësive

Seksioni 6: Faza operationale

Ky seksion trajton shqyrtimin SAI-t, se si organizata prokuruese menaxhon në vijim kontratën e nënshkruar. Kështu, SAI do të duhet të kontrollojë se çfarë hapash ka ndërmarrë subjekti i audituar, për të siguruar që çdo aset i ofruar në bazë të kontratës, është i përshtatshëm për qëllimin dhe se ofrimi i shërbimeve vazhdon të përmbushë kërkesat e biznesit të sektorit publik. Do të duhet gjithashtu të konfirmohet se marrëveshja ruan vlerën e parasë është llogaritur në mënyrë të përshtatshme dhe nuk janë çenuar mbarvajtia e marrëveshjeve përkatëse të kontratës. SAI, mund të ketë nevojë të rishikojë se si subjekti i audituar menaxhon ndryshimet dhe shpërndarjen e riskut midis vetes dhe kontraktorit, dhe se si, nëse është e mundur, subjekti mund të dalë nga kontrata.

Udhëzimet

36. A është aseti i përshtatshëm për qëllimin?
37. Dispozitat e shërbimit përmbushin nevojat e biznesit
38. Marrëveshja vazhdon të jetë vlerë për parane

39. Ruajtja e strukturave drejtuese dhe bashkëpunuese
40. Ruajtja e stafit të menaxhimit të kontratës
41. Mirëmbahet alokimi i duhur i riskut
42. Ekziston trajtim kontabël i përshtatshëm
43. Menaxhimi i përfundimit të kontratës

Përfundimi

Edhe pse qasja ndaj financimit publik/privat dhe koncesioneve tashmë është mirë vendosur në disa shtete, ajo është ende në zhvillim në disa shtete të tjerë. Praktikrat e mira në zbatimin e suksesshëm të projekteve të tilla kanë evoluar tashmë nga viti në vit dhe do të vazhdojë kështu. Udhëzimet e propozuara për këtë arsye duhet të shihet si sugjerime dhe këshilla, të vënë përpara në dritën e eksperiencës së deritanishme. Ata nuk janë ligje apo procedura, të cilat çdo SAI duhet të zbatojë në tërësinë e tyre për çdo rast. Qëllimi i tyre në thelb është të ofruarit e udhëzimeve për të siguruar që një auditim i tillë është profesional, i strukturuar dhe identifikon rekomandime të dobishme për marrëveshjet e ardhshme koncesionare. Ne besojmë se shumë nga çështjet e trajtuara do të mbeten të vlefshme dhe të përshtatshme, ndonëse qasjet në financimet publik/privat dhe koncesionet zhvillohen dita ditës.

Seksioni 1: Qasja e përgjithshme e SAI-it

Udhëzimi 1

Përgjegjësitë e SAI-it

Udhëzimi

SAI duhet të identifikojë se cilat nga përgjegjësitë e tij kanë lidhje me projektet e financimit publik/privat dhe koncesionet, dhe duhet të vendosë sesi ti kryej ato.

Arsyet për Udhëzimin

Pothuajse në të gjitha vendet, përgjegjësia për auditimin e strukturave shtetërore që lidhin kontrata për koncesione dhe financime publik/privat, i mbeten SAI-t. Kontrata të tilla mund të lidhen gjithashtu nga qeveria qendrore ose vendore. Kontratat e lidhura nga këto organe mund ose nuk mund të jenë në fushën e SAI-t, në varësi të kuadrit ligjor të auditimit në një shtet të caktuar. Në çdo rast SAI duhet të jetë i qartë se kush është përgjegjës për dhënien e çdo kontrate dhe cilat janë kompetencat e SAI-it për të audituar marrëveshjen.

Përdorimi nga një kompani private për të financuar dhe për të përdorur një , dhe me tej për të ofruar shërbime të asociuara, do të thotë se një sasi e madhe e të dhënave, do të mbahet nga kompania private dhe jo domosdoshmërisht nga agjencia publike prokurorese. Për këtë arsye, SAI duhet të jetë i qartë në lidhje me të drejtat që ka mbi një kompani private në marrëdhënie me një projekt publik/privat.

Në fushën e financimit publik/privat dhe të koncesioneve, mund të jetë veçanërisht e rëndësishme që strukturat shtetërore që lidhin këto kontrata, të ushtrojnë një gjykim të mirë-informuar dhe diskret. Përgjegjësitë e SAI-t nuk duhet të çojnë në zëvendësimin e vendimit të SAI-t mbi subjektin e audituar. Në të kundërt, duhet që qëllimi i SAI duhet të jetë inkurajimi i organeve të audituara për të ushtruar lirinë e tyre të veprimit me mençuri dhe maturi. Duke vepruar kështu, SAI mund të nxjerre mësim nga shqyrtimi i auditimive të rasteve të tjera në të cilat agjencitë shtetërore kanë ushtruar lirinë e tyre të veprimit.

Seksioni 1: Qasja e Përgjithshme e SAI-t

Udhëzimi 2

Përvetësimi i aftësive të nevojshme profesionale

Udhëzim

SAI-t duhet të identifikojnë dhe të sigurojnë aftësitë kryesore profesionale brenda institucionit, që i duhen për të kryer auditime të nivelit të lartë cilësor për projektet e financimit publik/privat dhe të koncesioneve, si dhe të plotësojë këto aftësi me mbështetje të ekspertëve të jashtëm, sipas nevojës.

Arsyet për Udhëzimin

Karakteristikë përcaktuese e projekteve të financimit publik/privat dhe koncesioneve është se subjektet e sektorit privat përfshihen shumë në ofrimin e shërbimeve të porositura nga shteti: një problem i qasje së sektorit privat me atë shtetëror. Për të siguruar shkallën e duhur të sigurisë në informimin e parlamentit dhe publikut për vlerën monetare të këtyre kontratave, SAI ka nevojë për një shumëllojshmëri aftësish, dhe jo në të njëjtin nivel si auditimet e zakonshme në sektorin publik.

Kështu, përveç aftësive të zakonshme të auditimit, të cilat shqyrtojnë çdo detyrë komplekse ose me risk të lartë si dhe realizojnë ekspertizë të veçantë në lidhje me asetet, SAI do të ketë nevojë për rekrutim stafi, ose për përdorimin e konsulentëve të jashtëm, të cilët janë më të specializuar në fusha specifike që lidhen me përdorimin e financave private. Në veçanti, aftësitë dhe njohuritë teknike lidhur me përdorimin e financave të projekteve janë të një rëndësie të veçantë, si një pjesë e konsiderueshme e projekteve publik/privat duke përdorur strukturat financiare të projektit.

Seksioni 1: Qasja e përgjithshme e SAI-t

Udhëzimi 3

Përfshirja e SAI-t

Udhëzim

SAI duhet të auditojë procesin e prokurimit të financimit publik/privat dhe koncesioneve sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi kontrata koncesionare është lidhur, dhe më pas duhet të ekzaminohet projekti përsëri në fazën operacionale dhe kur koncensionari/kontraktori është në fazën e ofrimit të shërbimeve të kontraktuara.

Arsyet për Udhëzimin

SAI përballet me një dilemë kur bëhet fjalë për rishikimin e financimit publik/privat dhe të koncesioneve përgjatë kryerjes së auditimit. Në shumë raste marrëveshja parasheh që operatori ekonomik i sektorit privat do të ofrojë shërbime për shumë vite, madje dekada në të ardhmen. Prandaj, do të jetë e mundur kryerja e vetëm një vlerësimi final nëse marrëveshja ka përmbushur vlerën e parasë. Megjithatë, ky është një afat kohor i gjatë për të nxjerrë mësim dhe të zbatohen përmirësime në projektet e mëvonshme dhe madje gjatë projektit nën shqyrtim.

Nevoja për të demonstruar përgjegjshmëri gjithashtu kërkon që marrëveshje të tilla të shqyrtohen sa më shpejt, që të arrihet në një pikë kur përfundimet e gjetura të kenë kuptim të plotë për vazhdimësinë të kontratës. Prandaj, SAI duhet të auditojë marrëveshjet e financimit publik/privat dhe të koncesioneve shumë para përfundimit të kontratës.

Një fazë e parë e mirë për të audituar këto marrëveshje duhet të jetë menjëherë pasi është lidhur marrëveshja. Auditimi i marrëveshjes fill pas nënshkrimit të kontratës, ka avantazhin që kushtet e marrëveshjes janë të fiksuara-para kësaj mund të ndryshojnë

vazhdimisht pasi do të jenë subjekt i rinegocimeve-dhe SAI ka mundësinë të japë opinion sesa kjo marrëveshje do të përmbushë kërkesat e ardhshme të autoriteteve publike.

Megjithatë, në rrethana të caktuara, kur është ligjërish e lejueshme, mund të jetë e nevojshme ose e dëshirueshme për SAI-n, të shqyrtojë marrëveshjen para se kontrata të nënshkruhet, për shembull, nëse janë duke u shprehur shqetësimet në lidhje me vlerën e mundshme ose të dëshirueshme të parasë në procesin e prokurimit. Gjithashtu, disa SAI kanë përgjegjësi ligjore për të shqyrtuar modelet financiare (p.sh. krahasueset e sektorit publik) të përdorura për të justifikuar mënyrën e prokurimit të financimit privat/publik, para nënshkrimit të kontratës. Auditimi në këtë fazë të projektit ka avantazhin se çdo dobësi të identifikuar nga SAI mund të korrigjohen para se kontrata të nënshkruhet dhe në këtë mënyrë shmangen vështirësitë serioze të fazave të mëvonshme. Kjo mund të jetë një mundësi e mirë për SAI-n, ku ai identifikon një projekt që përbën risk të konsiderueshëm për vlerën e parasë dhe shpreson ta ekzaminojë atë në fazat më të rëndësishme të prokurimit dhe operimit.

Në kryerjen e një ekzaminimi përpara nënshkrimit të kontratës, SAI duhet të menaxhojë risqet e përfshira në këtë fazë paraprake. Për shembull, risku që ekzaminimi i SAI-t mund të sjellë një ndikim negativ në procesin e tenderimit kur subjekti i audituar mund të devijojë burimet e veta nga negocimi i marrëveshjes më të mirë për të qënë korrekt me ekzaminimin e SAI-t, ose risku i vetë SAI-t që mund të ndeshet me konflikt interesi në momentin e dhënies së opinionit në një periudhë të mëvonshme nga ajo e ekzaminimit.

Rishikimi i hershëm i kontratës nga SAI, para ose vetëm pas dhënies së saj, nuk e ndalon SAI për t'u kthyer për të shqyrtuar atë përsëri në një datë të mëvonshme. Kontrolli i menaxhimit të vazhdueshëm i financimit publik/privat dhe kontratave të koncesioneve, pasi janë nënshkruar, është e rëndësishme për të siguruar vlerën afatgjatë të parasë për projektin. Prandaj, SAI duhet të marrë në konsideratë

auditimin e financimit publik/privat të projekteve të tilla gjatë fazës operacionale. Një ekzaminim (auditim) gjatë viteve të hershme të një kontrate të tillë, duhet të përqendrohet në analizimin nëse kontraktori i sektorit privat, ka dhënë rezultatet e deklaruara në kontratë. Çdo auditim, pasi kontrata ka operuar për një numër vitesh, duhet të fokusohet nëse sa mirë palët e sektorit privat dhe atij publik janë duke punuar së bashku, për të siguruar se përfundimet e kërkuara janë ndryshuar, për tu siguruar se janë në përputhje me ndryshimin e kërkesave të biznesit të autoritetit publik

Seksioni 1: Qasja e përgjithshme e SAI-t

Udhëzimi 4

Planifikimi i auditimit

Udhëzim

Në planifikimin e auditimit të financimit publik/privat dhe të koncesioneve, SAI duhet të planifikojë të mbulojë të gjitha aspektet kryesore të marrëveshjes që kanë një influencë mbi vlerën e parasë, siç është përcaktuar në udhëzimet e mëposhtme, për të identifikuar palët kyçe në marrëveshje dhe ku është e mundur, për të marrë prova nga ata, dhe duhet të jetë vigjilent për të nxjerrë mësim për të ardhmen.

Arsyet për Udhëzimin

Pa planifikim të mirë, SAI rrezikon të ndërmarrë një auditim që është i keq-fokusuar dhe ka mungesa në gjerësitë dhe thellësitë e provave të nevojshme për të siguruar një raport të besueshëm. Për të formuar një pamje mbi vlerën e parasë së një marrëveshje, SAI do të duhet të ketë qasje në organin e sektorit publik që ka lidhur kontratën. Megjithatë, për sa kohë projektet e financimit publik/privat dhe të koncesioneve përfshijnë një gamë të gjerë të palëve të treta, përveç organit të sektorit publik që ka lëshuar kontratën, SAI do të duhet gjithashtu të marrë pikëpamjet e këtyre palëve të tjera, për të arritur përfundime të bazuara mbi këtë marrëveshje.

Qëllimi i çdo shqyrtimi duhet të jetë për të identifikuar mësim për të ardhmen, në mënyrë që të arrihen dhe prokurohen marrëveshje efektive, dhe gjithashtu që të përmirësohet menaxhimi i vazhdueshëm i këtyre kontratave dhe performanca e kontraktorit. Nëse SAI do të jetë efektiv në këtë qëllim, planifikimi i tij i auditimit duhet të përfshijë sa mirë duhen prezantuar mësimet e identifikuara, në mënyrë që të performohen në të ardhmen.

Është e rëndësishme se shqyrtimi i SAI duhet, aq sa është e lejuar me ligj, të marrë parasysh të gjithë informacionin përkatës, duke përfshirë materiale që mund të jenë komercialisht të ndjeshme ose konfidenciale. Edhe nëse material i tillë nuk mund të jetë ose nuk duhet të publikohet në raportin përfundimtar të SAI-t, mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në konkluzionet tij.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 5

Përzgjedhja e projektit

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë në cilën mënyrë subjekti ka prioritzuar projektet potenciale, dhe nëse i ka zbatuar projektet në atë renditje prioriteti.

Arsyet për Udhëzimin

Përdorimi i financimit publik/privat ose i koncensioneve, mund të jetë një mjet nëpërmjet të cilit një projekt mund të dorëzohet më herët se sa nesë do të ishte financuar si një projekt tërësisht nga sektori publik. Ndërkohë që kjo mund të jetë një avantazh, tregon që projektet me cilësi të dobët, mund të zhvillohen thjesht sepse mund të financohen në këtë mënyrë, dhe se projektet me cilësi të lartë, të cilat mund të financohen vetëm si projekte publike, shtyhen. Ka kuptim në këtë mënyrë, për SAI-n të shqyrtojë se si entiteti i audituar ka vlerësuar prioritetet e tij midis projekteve konkurruese.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 6

Përcaktimi i kërkesave të projektit

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse entiteti i audituar ka deklaruar qartë kërkesat e tij që në fillim, dhe i ka shprehur këto në terma të rezultateve, duke bërë të qartë çdo kufizim të veçantë në të cilin sektori privat do të jetë subjekt.

Arsyet për udhëzimin

Është e rëndësishme për ofrimin e suksesshëm të çdo projekti që organizata të theksojë kërkesat e veta në mënyrë të qartë nga fillimi. Në të kundërt, ekziston rreziku që ajo do të përfundojë me një projekt që nuk i plotëson nevojat e saj reale. Për shembull, në një marrëveshje hekurudhore subjekti i audituar nuk ka zgjidhur fillimisht kërkesat e tij për udhëtimin koncesionar për kategori të caktuara të pasagjerëve. Rrjedhimisht, qeveria duhej të negocionte marrëveshje me kontraktorin pas dhënies së kontratës, kur pozicioni i saj i negocimit ishte i dobët.

Qasja e financimit publik/privat dhe koncensioneve, nëse është prokuruar në mënyrën e duhur, duhet të lejojë sektorin privat të ofrojë risi në fusha të tilla si ofrimi i shërbimeve. Megjithatë, shtrirja për të tilla risi është e kufizuar nëse klienti nuk arrin të specifikojë kërkesat e tij në terma të rezultateve dhe në vend të kësaj përqëndrohet në lëndët e para dhe mekanizmat e vënies në dispozicion, duke vendosur kufizime të panevojshme mbi atë se si sektori privat mund të kryejë projektin. Është e rëndësishme pra, që një organizatë të specifikojë nevojat e saj në drejtim të kërkesave. Mund të ketë arsye të mira përse disa kufizime të veçanta duhet të zbatohen, për shembull, mund të jetë e nevojshme të rregullohen tarifat ndaj publikut, për qëllime të caktuara mjedisore që duhet të plotësohen ose për sektorin privat të marrë përsipër asete shtetërore për një çmim të dhënë. Subjekti i

audituar duhet të konsultohet me të gjitha palët e interesuara të rëndësishme për tu siguruar se prodhohen specifikimet e duhura për projektin.

Në mënyrë që të shmangen humbjet në burimet e veta dhe ato të sektorit privat në planifikimin e projekteve, të cilat nuk kanë qenë kurrë të përballueshme që në fillim, subjekti i audituar do të duhet të identifikojë kufij të qartë të kostos të cilën mund ta përballojë. Gjithashtu duhet të identifikojë se çfarë fleksibiliteti kërkon, pasi kontrata të jetë funksionale, për të bërë ndryshime në specifikimet e shërbimit dhe për të rivlerësuar çmimin e paguar për këto shërbime, për të siguruar se janë duke u marrë vlerat afatgjata të parasë.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 7

Kapacitetet e sektorit privat

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka kryer një vlerësim paraprak të kapaciteteve të sektorit privat për arritjen e rezultateve të kërkuara.

Arsyet për Udhëzimin

Në përcaktimin se si do të shprehen rezultatet e dëshiruara, një organizatë duhet të ketë parasysh kapacitetet e sektorit privat. Kjo duhet të sigurojë që çdo projekt paraqitet në treg në mënyrë të tillë që prokurimet e mëvonshme mund të përparojnë hap pas hapi. Në disa raste, për shembull, në një shërbim menaxhimi të sistemit të pagave, sektori privat mund të jetë shumë familjar me llojin e rezultatit që ka premisa të jetë i kërkueshëm, dhe për këtë arsye lehtësisht i aftë për ta ofruar atë. Në vende të tjera, të tilla si aplikimet e reja të teknologjisë së informacionit, sektori privat mund të kenë nevojë për më shumë ndihmë për të kuptuar se cilat janë rezultatet e kërkuara. Kur është duke u zhvilluar një treg i ri, sektori publik mund të kenë nevojë për të kryer aktivitete, për të ndihmuar në zhvillimin e të kuptuarit ndërmjet ofertuesve të mundshëm. Partnerët e sektorit publik duhet të konsiderojnë me kujdes, në çdo projekt të mundshëm, në cilat kushte sektori privat do të kuptojnë më mirë kërkesat e tij.

Prandaj SAI duhet të shqyrtojë se çfarë matje fillestare të tregut kreu entiteti subjekti i audituar për të konstatuar se në cilën mënyrë sektori privat do të kuptojë më mirë kërkesat e tij dhe ndihmën shtesë që sektori privat do të duhet ketë për të fituar një kuptim të tillë.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 8

Vlerësimi i përfitimeve të mundshme

Udhëzim

SAI duhet të identifikojë nëse subjekti i audituar ka kryer një vlerësim paraprak të përfitimeve që kërkohen.

Arsyet për Udhëzimin

Në fazat e hershme të zhvillimit të projektit, subjekti i audituar duhet të ketë bërë një vlerësim paraprak të përfitimeve që ai është duke kërkuar nga projekti për ofrimin e shërbimeve në fjalë. Gjithashtu, duhet të identifikojë çdo lloj kostoje të mundshme dhe kufizime përsa i përket arritjes së këtyre përfitimeve. Një vlerësim i tillë, do të mundësonte subjektin të caktojë kritere të arsyeshme për vlerësimin e mëvonshëm të tenderave të pranuar. Në këtë mënyrë, SAI duhet të kontrollojë nëse subjekti i audituar ka qënë i qartë në lidhje me përfitimet nga projekti dhe ka përdorur përfitimet potenciale të identifikuara si bazë për përcaktimin e kritereve të vlerësimit të tenderave- duhet të confirmohet se subjekti i audituar nuk ka vendosur kriteret e vlerësimit në fund të procesit të prokurimit vetëm për të justifikuar arritjen e marrëveshjes.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 9

Objektivat e politikave më të gjithanshme

Udhëzim

SAI duhet të rishikojë se si ka ndikuar mbi projektin vlerësimi më i gjithanshëm i objektivave politike nga subjekti.

Arsyet për Udhëzimin

Në shumë fusha të biznesit të qeverisë, mund të ekzistojnë arsye politike ose rregullatore, të cilat vendosin kufizime në atë se si një shërbim i veçantë duhet lëvruar. Si pasojë, duhet të ekzistojë një ekuilibër midis këtyre kërkesave të përgjithshme të politikave dhe objektivave financiare ose cilësore të shërbimit, specifike ndaj projektit në fjalë. Për shembull, një qeveri mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të pensionit dhe të punësimit të stafit të sektorit publik të cilët transferohen në sektorin privat nëpërmjet marrëveshjeve të financimit publik/privat dhe koncesioneve. Organet prokuruese duhet të identifikojnë specifikimet ligjore dhe të kuptojnë thelbin e tyre, në mënyrë që të plotësojnë këto kërkesa dhe t'ia komunikojnë ato në mënyrë të qartë sektorit privat. Në një marrëveshje, për shembull, dështimi i subjektit auditues që nuk ka kuptuar në kohë objektivat në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve, ka sjellë si rezultat rishikimin e tenderit duke konsideruar që tenderuesit fillestarë nuk kishin adresuar me kujdes këtë çështje. Si rrjedhim SAI duhet të shqyrtojë se si subjekti i audituar i konsideroi objektivat e politikave kur planifikoi projektin dhe çfarë peshe u dha atyre.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 10

Përzgjedhja e formave më të përshtatshme të partneritetit

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar shqyrtoi në një gamë të mënyrave alternative të plotësimit të nevojave të tij, të tilla si prokurimet tradicionale të sektorit publik ose privatizimit, përpara zgjedhjes së opsionit të financimit publik/privat dhe koncesioneve.

Arsyet për Udhëzimin

Duke përcaktuar kërkesat e projektit, autoriteti prokurues duhet të identifikojë formën më të përshtatshme të partneritetit dhe/ose rrugën e prokurimit të projektit. Për shembull, në rastin e ndërtimit të rrugëve autoriteti prokurues do të duhet të vendosë nëse duhet të jetë një rrugë me tarifë përdorimi për çdo makinë, ose nëse do të jetë një projekt dizenjimi, ndërtimi, financimi dhe operimi i financuar nga tarifat e përdorimit për rrugë, disponueshmëria e pagesave, një përzierje e të dyjave ose ndoshta thjesht një dizenjimi dhe ndërtim. Prandaj, SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka analizuar përdorimin e mundshëm të një sërë mekanizmash të projekteve përpara zgjedhjes për të prokuruar projektin përmes financimit publik/privat dhe koncesioneve.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 11

Inovacioni

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka identifikuar paraprakisht hapësirat për risitë në fusha të tilla si projektimi dhe ndërtimi, operimi dhe financimi i projektit.

Arsyet për Udhëzimin

Qasja e financimit publik/privat dhe koncesioneve, mund të sjellë përmirësim të vlerës së parasë kur maksimizohet synimi i sektorit privat për të investuar në zhvillimin e risive në ofrimin e shërbimeve ose produkteve që subjekti prokurues i audituar kërkon (Udhëzimi 6). Që kjo të arrihet, është shumë e rëndësishme që prokuruesi të sigurojë se çdo lloj kufizimi i vendosur për risi, të jetë i justifikuar. Prandaj, SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka ndërmarrë një vlerësim paraprak të mundësisë për risi të mundshme, për të siguruar se çdo lloj kufizimi për këtë të jetë i justifikuar. Ky vlerësim, më tej do të sigurojë një sistem vlerësimi të çdo risije që mund të propozohet nga ofruesit.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 12

Vlerësimi i Riskut

Udhëzim

SAI duhet të rishikojë nëse subjekti i audituar ka hetuar paraprakisht për alokimin e duhur të risqeve të projektit midis paleve pjesëmarrëse publike dhe private të prekura nga projekti.

Arsyet për Udhëzimin

Alokimi i duhur i riskut midis sektorit publik dhe privat, është një kërkesë thelbësore nëse qasja e financimit publik/privat dhe koncensioneve ka premisa për të dhënë vlerë më të mirë të parasë sesa prokurimi konvencional. Në shumë raste, sektori privat menaxhon në mënyrë më të mirë risqet të cilat lindin në sektorin publik. Për këtë arsye, çdo kosto që lidhet me këtë risk duhet të ulet, nëse përgjegjësia për to i jepet sektorit privat. Nëse sektori publik kërkon të reduktojë riskun përmes transferimit të tij tek sektori privat, mund të ndodhë që sektori privat nuk e administron dot, vlera e parasë do të reduktohet pasi sektori privat do të kërkojë primin përkatës për korrjen e këtij risku. Për këtë arsye sektori publik nuk duhet të kërkojë reduktimin maksimal, por optimal të riskut; kjo do të thotë që nuk duhet të përpiqet të reduktojë të gjitha risqet me çdo lloj kostoje, por të alokojë risqet individuale në nivele më të mira, që ti menaxhojnë ato.

Sektori publik paraqet një pozitë të mirë për disa risqe. Në raste të tjera mund të ketë kuptim ndarja e riskut, për shembull duke alokuar një risk ndaj sektorit privat, ndërkohë që sektori publik të ofrojë disa lloj garancish, nëse ky risk materializohet. (Në këtë rast, SAI do të duhet të shqyrtojë arsyetimin për nivelin e garancisë dhe bazat për derivimin e shumës.) Gjithashtu e rëndësishme në lidhje me alokimin e riskut, mund të jenë marrëveshjet në të cilat sektori privat merr asetet publike, si

pjesë e marrëveshjes. Organizatat prokuruese në këtë mënyrë duhet të mendojnë paraprakisht nëse ka ndonjë aspekt të marrëveshjes së propozuar që do të hidhet në treg, që do të mund të arrijë alokimin optimal të riskut; për shembull duke krijuar risqe të reja të cilat do të bien mbi furnizuesit e sektorit privat.

Trajtimi kontabël i projektit në llogaritë e subjektit të audituar, mund të varet nga masa e transferimit të riskut në sektorin privat. Kjo mund të përbëjë një shtysë për subjektet e audituara që të transferojnë riskun në mënyrë që të sigurojnë një trajtim të vecantë të kontabilizimit-edhe nëse transferimi i riskut sjell vlerë të dobët të parasë. Prandaj është e rëndësishme për SAI-n të shqyrtojë masën e arsytimit të pranueshëm të përdorur për të transferuar riskun e projektit.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 13

Përballueshmëria dhe vlera e mundshme e parasë

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë shkallën në të cilën subjekti i audituar konsideron, para fillimit të procesit të prokurimit, nëse projekti ka patur premisa për të qënë i përballueshëm dhe nëse ofronte vlerë për paranë.

Arsyet për Udhëzimin

Pjesëmarrja në një projekt, i cili është parashikuar si i papërballueshëm ose i dobët për vlerën e parasë, është një humbje kohe dhe e parave, edhe përpara se ofertat të ishin kërkuara. Edhe pse organizata prokuruese mund të sfidojë tregun në mënyrë të arsyeshme duke kërkuar qasje të reja, duke përfshirë transferimin e riskut, shpesh është e mundur, vetëm me këshillim të jashtëm, të parashikohet kur tregu nuk ka mundësi të ofrojë një kërkesë të propozuar në një çmim të përballueshëm. Para se të kërkojë konsulencë të jashtme, organizmi i prokurimeve, duhet të tregojë që projekti i propozuar ka premisa të ofrojë vlerë për paranë krahasuar me opsionet e tjera, mund të përballojë shpenzimet e këtij projekti dhe se sektori privat mund të ofrojë shërbimet e kërkuara.

Vlera e parasë konsiston jo thjesht në koston më të ulët, por në kombinimin më të mirë të koston gjatë gjithë jetëgjatësisë së projektit, fleksibilitetin dhe cilësinë që plotëson kërkesat e një organizate. Vlerësimi i vlerës për para mund të përfshijë vlerësimin jo vetëm të përfitimeve financiare dhe shpenzimeve, por edhe të faktorëve jo financiarë.

Seksioni 2: Qëllimi i Projektit

Udhëzimi 14

Përvijimi i Rastit për Biznes

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka përgatitur një rast biznesi të përshtatshëm për të mbështetur vendimin për prokuruar një projekt.

Arsyet për Udhëzimin

Është praktikë e mirë, që formalisht të përvijohet rasti për biznes përmes procedimit me financim publik/privat dhe koncesion, në mënyrë që menaxhimi i lartë i organizatës të ketë evidenca të qarta për të marrë vendimin për të vepruar. Pa një rast të tillë për biznes, ekziston risku që një marrëveshje të bëhet thjesht sepse është e bëshme dhe jo sepse duhet të bëhet. Në këtë fazë të hershme një rast i tillë për biznes duhet të jetë vetëm i përvijuar së bashku me një rast për biznes më të detajuar, të përgatitur përpara vendimit të lidhjes së çfarëdolloj kontrate.

Kapitulli 3: Menaxhimi i Projektit

Udhëzimi 15

Stafi i projektit

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka vlerësuar aftësitë që do ti duhen për dorëzimin e projektit në mënyrë të suksesshme dhe si do ti sigurojë këto aftësi, për shembull nga stafi që disponon apo nga këshillues të jashtëm, dhe nëse subjekti ka grumbulluar më tej stafin e projektit brenda një kohe të favorshme.

Arsyet për Udhëzimin

Ashtu si përdorimi i financimit publik/privat ose koncesioneve paraqet nevojën që SAI të marrë aftësi alternative (Udhëzimi 1), ashtu edhe vetë subjekti i audituar mund të ketë patur nevojë të marrë aftësi të specializuara për të negociuar këto kontrata. Fakti që subjekti i audituar është i pajisur me aftësitë e duhuara në kohën e duhur, mund të sjellë një ndikim të madh në cilësinë e marrëveshjes. Proçedurat e raportimit dhe vendimmarrjes së grupit të projektimit duhet të jenë të qarta në mënyrë që kontrata e prokurimit të vijojë në mënyrë efikase dhe efektive.

Papërshtatshmëria e stafit të projektit mund të përbëjë një risk të lartë për vlerën e parasë. Kështu SAI do të duhet të identifikojë masat që ka ndërmarrë subjekti i audituar për të mbrojtur integritetin dhe objektivitetin e prokurimit. Për shembull, anëtarëve e stafit të projektit mund tu kërkohet të përmbushin dispozitat e një kodit të sjelljes.

Kapitulli 3: Menaxhimi i Projektit

Udhëzimi 16

Investigimi i Tregut

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka hetuar tregun para fillimit të procedurave të prokurimit, për të vërtetuar se ka patur furnizues të gatshëm për të marrë pjesë në procedurat e tenderit për projektin.

Arsyet për Udhëzimin

Si pjesë e planifikimit të prokurimit, subjekti i audituar duhet të hetojë tregun në lidhje me shërbimet në fjalë. Qëllimi i këtij hetimi është të informojë mënyrën si paraqitet projekti në treg, që furnizuesit potencialë të jenë në gjendje të vlerësojnë shtrirjen e plotë të mundësive të biznesit që ai ofron. Prandaj është e dobishme që të diskutohet një projekt potencial me ofertues të mundshëm në mënyrë që të identifikohen aspektet e projektit që kanë interes, dhe ato që mund të mos jenë interesante. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur projekti është i një lloji të ri. Megjithatë, kur bëhen diskutime të tilla, subjekti i audituar do të duhet të mbajë parasysh dispozitat ligjore dhe rregulloret në fushën e prokurimeve.

Seksioni 3: Menaxhimi i Projektit

Udhëzimi 17

Çështjet Kontraktuale

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka identifikuar çështjet kontraktuale që kanë gjasa të rezultojnë gjatë procesit të prokurimit dhe nëse është hartuar një kontratë paraprake, duke evidentuar propozimet fillestare për çdo çështje.

Arsyet për Udhëzimin

Rezultati i prokurimit do të jetë lidhja e kontratës me partnerin e sektorit privat. Prandaj është një fazë e rëndësishme e planifikimit të prokurimit shqyrtimi se çfarë dispozitash do të lindin gjatë negocimit të kontratës. Prandaj, SAI duhet të shqyrtojë nëse në fillim të projektit subjekti ka identifikuar çështjet kontraktuale që mund të lindin (për shembull, ndërprerja përpara afatit të kontratës, ndryshimet e çmimit të kontratës) dhe nëse është hartuar një kontratë paraprake, e cila pasqyron pozicionin e dëshiruar në secilën çështje. Qëllimi duhet të jetë realizimi, sa më shpejt të jetë e mundur, i një kontrate e cila në mënyrë të përshtatshme mbron pozicionin e sektorit publik, por që në të njëjtën kohë është e pranueshme për ofertuesin e sektorit privat dhe financuesit e tij. Kështu këshilla të hershme ligjore do të ishin thelbësore për subjektin e audituar.

Seksioni 3: Menaxhimi i Projektit

Udhëzimi 18

Strategjia e Tenderit

Udhëzim

SAI duhet të identifikojë nëse subjekti i audituar ka përgatitur një strategji tenderimi, e cila përfshin numrin e herëve kur do të zhvillohet tenderi, numrin e ofertave që do të ftohen në çdo fazë të tenderit, qasjen e subjektit për të komunikuar me ofertuesin, dhe një orar për procesin e tenderit.

Arsyet për Udhëzimin

Konkurrenca është zakonisht një faktor i rëndësishëm për të ndihmuar një organizëm prokurimi të lidhë një marrëveshje që siguron vlerë për paranë. Për të siguruar konkurrencën maksimale, organizmi do të duhet të planifikojë prokurimin duke mbajtur parasysh këtë qëllim. Një pjesë e rëndësishme e këtij planifikimi është strategjia e tenderimit, e cila përcakton numrin e fazave të tenderit dhe ofertuesve në çdo fazë, si do të komunikojë organizata me ofertuesit, dhe orari për ushtrimin e tenderit.

Parimi që duhet të udhëheqë strategjinë e tenderimit, është maksimizimi i tensionit të konkurrencës në mënyrë që ofertuesit gjithmonë do të ndihen nën presion për të vendosur ofertat më të mira të mundshme. Tensioni i konkurrencës do të jetë më i madh kur ofertuesit do të konkurrojnë fort me njëri-tjetrin. Ofertuesit, ka pak mundësi të jenë të gatshëm për të konkurruar fuqishëm në qoftë se një institucion prokurues kërkon që një numër të tepërt të shoqërive të dorëzojnë ofertat dhe të angazhojnë burimet e konsiderueshme për përgatitjen e një oferte të plotë. Pra, do të ketë kuptim për një institucion, në përgatitjen e strategjisë së tij, të konsiderojë kohën dhe kostot e ofertuesve në përgatitjen e ofertave dhe të kufizojë fazat në minimum në përputhje me një konkurrencë të suksesshme.

Do të ketë raste ku konkurrenca për një kontratë nuk do të jetë e madhe, për shembull, kur shërbimi i kërkuar është i një natyre specifike teknike dhe ka pak furnizues të këtyre shërbimeve në fushën përkatëse. Në raste të tilla, kur konkurrenca do të jetë e kufizuar, është e rëndësishme që strategjia e tenderimit të trajtojë riskun e vlerës për para dhe të propozojë masat lehtësuese për të ndihmuar dhe për të siguruar që institucioni i prokurimit të marrë një ofertë të mirë.

Seksioni 3: Menaxhimi i Projektit

Udhëzimi 19

Orari i projektit

Udhëzim

SAI duhet të identifikojë nëse subjekti i audituar ka përgatitur një afat të besueshëm të projektit, i cili identifikon kufijtë të cilat shërbejnë për të matur progresin, dhe pikat brenda procesit në të cilat subjekti duhet të kontrollonte zbatueshmërinë e vazhdueshme të projektit.

Arsyet për Udhëzimin

Kur pranifikon prokurimin, subjekti i audituar duhet të azhurnojë kohën e projekti në rastin e biznesit të përvijuar (Udhëzimi 14) për të reflektuar kohën ushtrimit të tenderit pjesë e strategjisë së tenderit. (Udhëzimi 18). Koha e ushtrimit të projektit do të jetë më gjithëpërfshirëse se sa koha e ushtrimit të tenderit, sepse duhet të reflektohet puna e detajuar që duhet bërë nga stafi i projektit dhe nga kontraktori përpara se të lidhet kontrata dhe të fillojë shërbimi i shpërndarjes. Aty ku është e mundur, kjo kohë duhet të përmbajë kufi ndaj të cilave mund të matet progresi dhe të përcaktohen pika të ndryshme në orar ku subjekti i audituar do të ndalojë për të rishikuar në mënyrë kritike nëse është e frytshme të vazhdohet me projektin.

Kapitulli 3: Menaxhimi i projektit

Udhëzimi 20

Krahasimi kosto/përfitim

Udhëzim

SAI duhet të vlerësojë nëse subjekti i audituar ka vlerësuar kostot dhe përfitimet e opsionit të financimit publik/privat përkundrejt një opsioni alternativ prokurimi.

Arsyet për Udhëzimin

Vendimi, nëse një propozim për financimin publik/privat dhe marrëveshjeve koncensionare përfaqëson vlerë për paratë, do të jetë më mirë i informuar nëse organizmi prokurues prodhon detaje të krahasueshi kostosh me anë të të cilit kostoja e financimit publik/privat dhe marrëveshjeve koncensionare mund të matet më tej.

Dy krahasues kostosh tipik janë, krahasuesi i sektorit publik dhe modeli kosto- e domosdoshme. Krahasuesi i sektorit publik zakonisht modelohet si llogaritje e kostove të mënyrës alternative të financimit publik për të ofruar dhe kryer një projekt; kjo zakonisht përdoret që të kuptohet se çfarë kostoje do të kishte nëse do të ishte përdorur metoda tradicionale e prokurimit dhe asetit që do të rezultonte do të operohej nga autoriteti prokurues. Modeli kosto – e domosdoshme zakonisht përdoret që të kuptohet një llogaritje e pavarur të kostove të pritshme të ofrimit të së njëjtës zgjidhje teknike siç është propozuar nga ofertuesi.

Përveç krahasimit të potencialit duhet të kryhet gjithashtu nga subjekti i audituar një analizë e përfitimeve të përdorimit të mënyrave të ndryshme të prokurimit. Kjo analizë e përfitimeve duhet të përdoret së bashku me krahasuesit e kostove, për të ndihmuar në vendimin nëse një mënyrë prokurimi përmes financimit publik/privat është opsioni më i mirë për tu zbatuar. Është relativisht e thjeshtë që të manipulohen të dhënat për të nxjerrë rezultatet e dëshiruara. Edhe modelet komplekse bien pre e gabimeve. Kështu që SAI duhet të kontrollojë detajet e çdo krahasimi të tillë në tërësi, në mënyrë që të vendosë nëse kostot dhe përfitimet e parashikuara të opsioneve të ndryshme të prokurimit janë të arsyeshme.

Seksioni 3: Menaxhimi i projektit

Udhëzimi 21

Lista e Tenderit

Udhëzim

SAI duhet të vlerësojë nëse subjekti i audituar ka arritur të krijojë me sukses një listë të mirë tenderimi.

Arsyet për Udhëzimin

Konkurenca është e rëndësishme për të marrë vlera të mira nga marrëveshjet e financimit publik/privat dhe marrëveshjeve koncensionare. Një nga kushtet kyçe për një konkurrencë të suksesshme është një listë e mirë tenderimi të firmave të ftuara për të ofruar. Një listë e tillë nuk pritët të krijohet vetë. Një organizatë prokurimi duhet të stimulojë aktivisht interesin në projektin e propozuar, të reklamojë garën e prokurimit në përputhje me ligjet dhe rregullimet e nevojshme dhe të japë të gjitha udhëzimet e nevojshme tenderueseve potencialë se si të japin një ofertë. Prokuruesi mund të asistojë procesin nëpërmjet të cilit firmat mund të bëhen të ndërgjegjshme për interesat e njëra tjerës dhe të vijnë së bashku në partneritet. E gjithë kjo, sigurisht, që duhet bërë në përputhje me strukturën ligjore.

Pas stimulimit të interesit të tregut, organizmi prokurues duhet të zgjedhë për listën e tenderimit firmat me aftësi të mira teknike, menaxheriale dhe organizative. Pa këto aftësi, është e pamundur që një firmë të ketë aftësi për të ofruar shërbimet e kërkuara dhe të fitojë kontratën. Organizmi prokurues, kur zgjedh listën e tenderit, duhet gjithashtu, të vlerësojë vullnetin dhe aftësinë e firmës për të dhënë një ofertë. Eksperienca ka treguar që firmat të cilat shfaqin interes dhe më tej ftohen në tender, dështojnë në dhënien e ofertës, gjë që rezulton në pakësimin e madhësisë së konkurrencës.

Seksioni 3: Menaxhimi i projektit

Udhëzimi 22

Specifikimet e kërkesave

Udhëzim

SAI duhet të konsiderojë nëse subjekti i audituar ka bërë specifikime të qarta të kërkesave.

Arsyet për Udhëzimin

Një kusht për konkurrencën e suksesshme është specifikimi i qartë i kërkesave të organizmit prokurues. Tenderuesit nuk mund të ofrojnë një ofertë të mirë nëqoftëse ata nuk njohin qartë se çfarë kërkon organizmi prokurues. Mungesa e specifikimeve të qarta mund të rezultojë në dhënien e një numri të kufizuar ofertash të cilat plotësojnë kërkesat, në këtë mënyrë pakësohet madhësia e konkurrencës. Sidoqoftë, vetë qartësia është e pamjaftueshme. Një specifikim i qartë mund të rezultojë me vlerë të dobët për paranë nëse nuk vë në dukje nevojat reale të organizmit prokurues ose nëse përmban detaje të tepruara, veçanërisht detaje që fokusohen te lëndët e para në vend që të fokusohen në produktin e dëshiruar. Specifikimi i lëndëve të para ose i metodës së lëvrimit të shërbimit do të kufizojë inovacionin (Udhëzimi 6). Në përcaktimin se kur një specifikim është mjaftueshëm i qartë, SAI duhet të konsiderojë nëse specifikimi i adresohet nevojave reale të organizmit prokurues dhe a ka qënë mjaftueshmërisht e bazuar në rezultatet. Vëmendje e veçantë duhet dhënë për cilësinë e shërbimit, i identifikuar si i kërkuar, kur një nga objektivat kryesore të dhënies së shërbimit me konçesion është përmirësimi i cilësisë.

Seksioni 3: Menaxhimi i projektit

Udhëzimi 23

Ruajtja e konkurrencës

Udhëzim

SAI duhet të identifikojë nëse subjekti i audituar ka arritur ruajtjen në mënyrë të suksesshme të tensionit të konkurrencës dhe nëse ka mirë-menaxhuar negociatat me ofertuesit e preferuar.

Arsyet për Udhëzimin

Ruajtja e tensionit të konkurrencës përgjatë procesit të prokurimit është një faktor i rëndësishëm për arritjen e një kontrate sa më të mirë e cila është vlerë për parane sepse ndihmon në evidentimin e ofertës më të mirë nga tenderuesit. Ka një risk për autoritetin prokurues që kushtet e marrëveshjes mund të ndryshojnë në dëm të tij, kur ose nëse negociatat kryhen vetëm me një furnizues potencial dhe tensioni e konkurrencës efektivisht është zhdukur. SAI duhet të vëjë në dukje nëse subjekti i audituar ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar që tensioni i konkurrencës është ruajtur deri në lidhjen e kontratës.

Seksioni 3: Menaxhimi i projektit

Udhëzimi 24

Rishikime të rregullta

Udhëzim

SAI duhet të identifikojë nëse gjatë prokurimit subjekti i audituar ka theksuar në mënyrë të rregullt që projekti vazhdimisht të ofrojë vlerë për paranë.

Arsyet për Udhëzimin

Është shumë e rëndësishme që organizmi prokurues të mos humbasi vëmendjen nga qëllimi fillestar të projektit gjatë serive të negociatave të detajuara, për të shmangur vazhdimin me një projekt i cilin nuk ka më vlerë dhe duke humbur kohë menaxheriale dhe duke korrur kosto të panevojshme. Për këtë arsye, një person i pa përfshirë direkt në negociata duhet të jetë përgjegjës për të konsideruar, gjatë zhvillimit të negociatave, nëse rezultati i pritur është në përputhje të plotë me objektivat e vendosura në fillim. Në shumë raste caktohen specifikisht këshilltarë të jashtëm për të kryer këtë rol monitorues; në raste të tjera këtë rol e ka kryer dhe audit i brendshëm. Çdo shmangie e rëndësishme duhet të raportohet te menaxhimi i lartë i organizmit prokurues menjëherë pasi është përcaktuar (ose ka probabilitet të lartë) dhe duhet të shikohet për një vendim nëse duhet ndryshuar objektivi apo të ndërpritet marrëveshja. Menaxhimi i lartë duhet të kontaktohet në çdo rast për progresin e projekteve të rëndësishme.

SAI duhet të ekzaminojë nëse, pas përgatitjes projekt idesë të rastit për biznes (Udhëzimi 14), stafi i projektit të subjektit të audituar ka kontrolluar në mënyrë të rregullt projektin për të identifikuar nëse ishte akoma i vlefshëm dhe nëse, në momente kyçe gjatë progresit të prokurimit, menaxhimi i lartë i subjektit të audituar ka kërkuar siguri mbi këtë çështje nga stafi i projektit.

Seksioni 3: Menaxhimi i projektit

Udhëzim 25

Buxheti për kostot e projektit

Udhëzim

SAI duhet të ekzaminojë nëse subjekti i audituar ka përcaktuar dhe kontrolluar buxhetet reale për të gjitha kostot e projekteve, përfshirë këtu burimet e brendshme dhe të jashtme.

Arsyet për Udhëzimin

Prokurimi i marrëveshjeve të financimit publik/privat dhe marrëveshjeve koncesionare, shpesh përfshin organizmin prokurues në kosto të larta. Principet e kontrollit të kostove aplikohen. Subjekti i audituar vazhdimisht duhet të ketë përcaktuar buxhete për kostot e tij sa më shpejtë të jetë e mundur. Kjo mund të jetë e vështirë pasi subjekti mund të jetë pa eksperiencë në prokurimin e financimit publik/privat dhe koncesioneve dhe të ketë pak njohuri të sasisë së punës që kjo kërkon. Sidoqoftë, mund të jetë e vështirë për të përcaktuar një buxhet të qëndrueshëm për kostot në fillimin e prokurimit, kjo nuk është arsyeja që të dështohet në përcaktimin e një buxheti fillestar dhe më pas rishikimin e tij kur bëhen disponibël më shumë informacione për punën që duhet kryer.

Buxhetet duhet të përcaktohen dhe të kontrollohen me baza projektsh dhe duhet të kenë përfshirë jo vetëm shpenzimet e këshilltareve të jashtëm por dhe burimet e brendshme. Për këshilltarët e jashtëm është një praktikë e mirë që të përcaktohen buxhete për detyra individuale që ata duhet të kryejnë.

Seksioni 3: Menaxhimi i projektit

Udhëzimi 26

Emërimi i këshilltarëve

Udhëzim

SAI duhet të kontrollojë nëse subjekti i audituar ka emëruar përmes konkurimit këshilltarët e jashtëm cilësor.

Arsyet për Udhëzimin

Këshilltarë të jashtëm me aftësi të mira mund të jenë thelbësor për një negociim të suksesshëm të financimit publik/privat dhe të marrëveshjeve koncensionare. Mënyra më e mirë për të siguruar këshilltarë të tillë vijnë pas një konkurrimi vetëm nëse konkurrimi është bërë midis një sërë firmash të cilësisë së mirë. Princiipi pas një konkurrimi të tillë është të arrihen këshilltarë të cilët sigurojnë vlerën më të mirë për paranë. Nuk është e nevojshme që ata të jenë këshilltarët me çmimin më të ulët, por kjo nuk do të thotë që nuk ka vend për tensionin e konkurrencës mbi faturat që këshilltarët duan të faturonjë. Kështu që, kur zgjidhen këshilltarët, subjekti i audituar duhet të ketë marrë në konsideratë jo vetëm çmimin por edhe cilësinë e këshillimit. Subjekti i audituar duhet të sigurojë që çdo këshilltar i emëruar të mos ketë konflikt interesi, pra që ata të mos kenë punuar apo të punojnë për ndonjë nga firmat ofertuese për projektin ose nëse ky konflikt interesi ekziston në mënyrë të tillë që proceset e përshtatshme të pozicionohen për të menaxhuar konflikte të tilla ose konflikte të perceptuara. Këshilltari, nëse ka marrëdhënie pune me ndonjë nga ofertuesit, ose duhet ta refuzojë këte detyrë ose të vendosë masa sigurie për të siguruar që stafi i tij, i cili punon për organizmin prokurues, është totalisht i ndarë dhe nuk ka kontakt me stafin e përfshirë, ose të përfshirë më përpara, që punojnë me ofertuesit.

Në momentin që vendoset performanca e këshilltarëve, duhet të kryhet monitorimi se ata po japin këshillat cilësore të kërkuara në koston e faturuar që ata specifikuan në tender.

Seksioni 3: Menaxhimi i projektit

Udhëzimi 27

Menaxhimi i kostos

Udhëzim

SAI duhet të kontrollojë se si subjekti i audituar ka monitoruar dhe menaxhuar kostot e veta të projektit, përfshirë këtu burimet e jashtme dhe të brendshme.

Arsyet për Udhëzimin

Kontrolli i kostove konsiston jo vetëm në përcaktimin e buxhetit (Udhëzimi 25), por gjithashtu edhe në monitorimin e rregullt të kostove të korrura kundrejt këtij buxheti. Në këtë mënyrë subjekti i audituar duhet të ketë kryer monitorim për të gjitha kostot, përfshi këtu burimet e brendshme dhe të jashtme, dhe vetëm buxhetet e rritura për detyra shtesë të mirë përcaktuara. Subjekti duhet gjithashtu të identifikojë qartë punën që pritët nga këshilltarët kundrejt faturës së tyre. Specifikime të paqarta ose të pa plota të punës së kërkuar nga një këshilltar, mund të rezultojnë në nevojën për marrëveshje kontraktuale shtesë dhe me pagesë shtesë faturimi. Si pjesë e ekzaminimit të menaxhimit të kostove të projektit, SAI duhet të kontrollojë përshtatshmërinë e bazave me të cilat subjekti i audituar zgjedhi shpërblimin e këshilltarëve. Subjekti duhet të ketë zgjedhur një bazë e cila ka nxitur këshilltarët në plotësimin e objektivave të projektit, ndërkohë që kontrollon kostot e veta. Në të njëjtën kohë, nëse këshilltarët e jashtëm janë kontraktuar për të dhënë këshilla sipas meritave dhe metodave të vazhdimtë të projektit, baza sipas të cilës jepet shpërblimi nuk duhet të krijojë konflikt interesi ose të shtrembërojë këshillën e dhënë. Nëse këshilltarët janë të detyruar të kryejnë një volum të madh pune, SAI mund të ekzaminojë nëse këshilltarët janë ndjerë në presion për të ofruar një zbritje çmimi në krahasim me vlerat e zakonshme të faturave të tyre.

Seksioni 4: Tenderimi

Udhëzim 28

Propozimet e ofertuesve

Udhëzim

SAI duhet të ekzaminojë nëse një linjë e gjerë zgjidhjesh është propozuar nga ofertuesit.

Arsyet për Udhëzimin

Një nga mënyrat kryesore, sipas të cilës përdorimi i financimit publik/privat ose koncesioneve mund të përmirësojë vlerën për para të përfituar nga sektori publik, është nëpërmjet inovacioneve. Në ekzaminimin e efektshmërisë së prokurimit, ka kuptim për SAI-n të shohë se sa larg ka shkuar sukcesi i subjektit të audituar në nxjerrjen nga ofertuesit të një numri të zgjidhjeve të ndryshme inovative, në problemin e arritjes së asaj që subjekti i audituar kërkon. Nëse nuk ekziston një linjë e gjërë zgjidhjesh, kjo mund të jetë shenjë që specifikimet e subjektit të audituar të jenë shprehur më shumë në terma të lëndëve të para duke kufizuar kështu hapësirën për inovacion. SAI duhet të kontrollojë nëse ofertuesit sugjeruan një varietet të zgjidhjeve inovative praktike në fushat e dizenjimit të asetit, operacionet e shërbimeve, financimeve, variacionin nga specifikimet dhe në shpërndarjen e riskut mes palëve të sektorit publik dhe privat.

Seksioni 4: Tenderimi

Udhëzimi 29

Vlerësimi i Ofertës

Udhëzim

SAI duhet të identifikojë nëse subjekti i audituar ka zhvilluar një gamë të gjerë të vlerësimit të ofertave.

Arsyet për Udhëzimin

Pas marrjes së ofertave faza e radhës është vlerësimi tyre nga subjekti i audituar. Vlerësimi i ofertave duhet të konsiderojë në mënyrë të plotë të gjitha aspektet financiare dhe jo financiare të propozimeve të ofertuesve, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm vlerën e parasë së marrëveshjes. Kështu që kriteri për vlerësim nuk duhet të jetë vetëm çmimi ose çmimi në varësi të pajtueshmërisë teknike me specifikimet e shërbimit. Subjekti i audituar duhet të mbajë përgjegjësi për çështje të tilla si niveli i riskut të ndërmarrë nga furnizuesit potencialë, shtrirja e inovacioneve, dhe lëshimeve mes çmimit apo cilësisë. Për shkak të kompleksitetit të vlerësimit, ka shumë mundësi që të nevojitet ushtrimi i gjykimit të informuar. Ushtrimi i këtij gjykimi duhet, sidoqoftë, të jetë brenda kontekstit të kornizës së vlerësimit, e cila siguron që metoda e vlerësimit është konsistente me objektivat për projektin e subjektit të audituar, dhe me atë se çfarë u është thënë tenderueseve për kërkesat. Që të jetë efektive, subjekti i audituar duhet ta ketë përcaktuar këtë kornizë në fazat fillestare të prokurimit (Udhëzimi 8). Ka kuptim, që në fillim të vlerësimit të ofertës, subjekti i audituar të vlerësojë në mënyrë të pavarur secilin nga këta faktorë, për shembull nëpërmjet përdorimit pragmatik dhe pa burokraci, të grupeve të pavarura të punës të ekzaminonjë aspektet madhore të vlerësimit. Kjo ndihmon në shmangien e ndonjë risku që vlerësimi fillestar teknik dhe cilësor i aspekteve të shërbimit të ofertës të mund të anohet padrejtësisht nga njohja e çmimit të propozuar.

Seksioni 4: Tenderimi

Udhëzimi 30

Zgjedhja e Ofertuesit

Udhëzim

SAI duhet të kontrollojë se si subjekti i audituar ka vlerësuar rezultatet e vlerësimit duke zgjedhur kështu ofertën me vlerën më të mirë.

Arsyet për Udhëzimin

Zgjedhja përfundimtare për ofertën fituese ka mundësi të ndezë lëshimet mes çmimit dhe cilësisë të propozuar nga ofertuesi. Në këto rrethana, përfundimet e analizave të ndara të aspekteve të ofertave të marra (Udhëzimi 29) duhet të mblidhen së bashku në një renditje gjithëpërfshirëse. Duke realizuar këtë, organizmi prokurues do të jetë i aftë të adresojë këto lëshime në mënyrë të detajuar në vlerësimin final të ofertave, duke marrë në konsideratë faktorët financiarë dhe jofinanciarë dhe do të mund të identifikojë ofertën që jep kombinimin më të mirë të tyre.

Në rastin kur është marrë vetëm një ofertë, është e pamundur që të ndërtohet një renditje e tillë. Megjithatë, është praktikë e mirë për një ofertë të vetme të vlerësohet kundrejt një strukture vlerësimi për të matur cilësinë e saj. Situata mund të kalonte menjëherë nga një ftesë për ofertë në një negociatë me një ofertë të vetme. Në këtë rast aplikohet Udhëzimi 31.

Është e rëndësishme për organizmin prokurues që të përcaktojë një sistem pikësh të qëndrueshëm për të renditur ofertat. Sidoqoftë, ata duhet të shmangin ndjekjen e skemave matematikore krahasuese duke qenë së është e pamundur që kjo skemë vlerësimi të mund të përfaqësojë saktë vlerën e ofertave të ndryshme në një fushë kaq komplekse sa projektet e financimit publik/privat dhe të koncensioneve. Një

skemë e tillë vlerësimi nuk duhet të përdoret si një zëvendësuese për ushtrimin e një gjykimi të informuar, të nevojshëm, kur përpqimi të adresojmë lëshimet mes çmimit dhe cilësisë. Organizatat duhet të jenë të përgatitura që të jenë fleksibile dhe të hapura ndaj alternativave, propozimeve inovative. Pavarësisht përjashtimeve, skemat e vlerësimit së bashku me linjat e trajtuara më sipër, mund të japin një disiplinë të dobishme për të siguruar që një kontratë nuk vlerësohet vetëm në bazë të kostos, por ka shkuar në vlerën më të mirë të ofertës, do më thënë kombinimin e çmimit, cilësisë së shërbimit dhe reduktimit të riskut që u përshtatet më mirë atyre.

Meqë vlerësimi final i ofertave është një fazë kritike në ushtrimin e prokurimit, SAI duhet të shqetësohet për të parë nëse subjekti i audituar ka zgjedhur me kujdes marrëveshjen më të mirë të mundshme duke përdorur vazhdimisht aplikimin e kritereve të vlerësimit.

Seksioni 5: Kontrata e Duhur

Udhëzim 31

Ndryshimet gjatë negociatave me ofruesin fitues

Udhëzim

SAI duhet të vlerësojë nëse ka patur ndonjë ndryshim, dhe nëse po, si ka vepruar subjekti i audituar për të minimizuar ndryshimet e termave të marrëveshjes gjatë negociatave me ofertuesin fitues.

Arsyet për Udhëzimin

Për shkak të kompleksitetit të marrëveshjeve të financimit publik/privat dhe marrëveshjeve koncensionare, nuk është e zakonshme për ofruesit të paraqesin oferta finale të cilat nuk janë të kushtëzuara që të rezultojnë, zakonisht në afate të gjata të kenë negociata ekskluzive me një ofrues të parapëlqyer.

Gjatë kësaj kohe, është e pashmangshme që të ketë dobësim të tensionit të konkurrencës. Derisa organizmi prokurues të mbajë një kontroll të kujdesshëm mbi koncensionet me ofruesin e preferuar, ka një risk në ndryshimin e termave të marrëveshjes, duke u kthyer në më pak të dëshirueshëm për prokuruesin. Idealisht, këto negociata ekskluzive duhet të kenë shumë pak lidhje me termat e detajuar të marrëveshjes, pasi çështjet parimore në lidhje me këto detaje duhet të ishin aprovuar përpara zgjedhjes së ofruesit të preferuar. Sidoqoftë përkeqësimi i termave të kontratës për prokuruesin shpesh ndodh kur çështje të rëndësishme parimore nuk janë aprovuar ende në këtë pikë të përzgjedhjes. Për shembull, në një projekt të një parku automjetesh, negociatat me ofruesin e preferuar fillojnë përpara se të identifikohet një rezultat superior në terma të riskut dhe të fitimit. Kështu që SAI duhet të rishikojë se si subjekti i audituar ka menaxhuar këtë fazë të prokurimit për të siguruar që koncensionet ndaj ofruesit të preferuar të minimizohen.

Seksioni 5: Kontrata e Duhur

Udhëzim 32

Arritja e objektivave

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse marrëveshja plotëson objektivat fillestare të projektit, ose të rrethanave të fundit nëse këto objektiva ndryshuan gjatë prokurimit. Për rastin e dytë, SAI duhet të ekzaminojë rëndësinë e këtyre ndryshimeve

Arsyet për Udhëzimin

Një kërkesë kyçe për çdo projekt është që ai duhet të kryejë atë funksion për të cilin është krijuar. Sidoqoftë, është e mundur që një marrëveshje ku kontrata është lidhur, mund të mos arrijë kërkesat e vendosura nga subjekti i audituar, dhe kështu ajo nuk ofron vlerë për paranë. Kjo mund të ndodhi kur një projekt publik/privat ose koncesionar, është shumë kompleks dhe mund të duhen muaj për tu negociuar. Për pasojë, ka një risk që subjekti i audituar të humbasë objektivat fillestare. Në të kundërt, objektivat e subjektit të audituar mund të kenë ndryshuar gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu mund të jetë dhe rasti që termat e nevojshëm për të plotësuar objektivat, thjesht nuk ishin të disponueshëm në treg.

Për të shmangur vazhdimin e një marrëveshje e cila nuk plotëson objektivat, menaxhimi i lartë i subjektit të audituar duhet të kishte vlerësuar me intervale të rregullta, gjatë kohës së prokurimit, nëse marrëveshja ishte akoma e frytshme (Udhëzimi 24). Veçanërisht e rëndësishme është që subjekti të ketë kryer këtë rishikim përpara se të ketë nënshkruar kontratën, sepse subjekti i audituar nuk do të ketë mundësi të kthejë pas marrëveshjen pas kësaj pike. SAI duhet të kontrollojë, nëse menjëherë para nënshkrimit të kontratës menaxhimi i lartë i subjektit të audituar ka vlerësuar marrëveshjen e negociuar, për të siguruar që i plotëson objektivat, ose ato të vendosura në fillim ose ato të mëvonshmet, në rast ndryshimi.

Rishikimi duhet gjithashtu të marrë përgjegjësi të plotë për çdo ndryshim të politikave që mund të ndodhnin në një të ardhme të parashikuar. SAI mund të marrë siguri nga rishikimi i tyre për këtë vlerësim, se marrëveshja e firmosur plotëson objektivat e vendosura nga subjekti i audituar.

Një subjekt nën auditim duhet ketë kujdes kur ndryshon objektivat e saj sepse mund të duket nga tenderuesit potencial si një tradhti, që do të reduktojë perspektivat e sektorit publik për të arritur marrëveshje të mira të financimi publik/privat dhe koncensionar. Nëse një subjekt i audituar, ka ndryshuar objektivat e tij gjatë prokurimit, SAI duhet të kontrollojë nëse është marrë këshillim i mirë dhe duhet të shqyrtojë çdo problem ligjor që mund të lindë nga ky ndryshim, për shembull risku i procedimit ligjor nga ofruesit.

Seksioni 5: Kontrata e Duhur

Udhëzimi 33

Vlerësimi i alternativave

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka konfirmuar që marrëveshja e propozuar ofron vlerën më të mirë për paranë, krahasuar me alternativa të arsyeshme, përpara së të lidhet kontrata.

Arsyet për Udhëzimin

Për të përcaktuar nëse një marrëveshje e financimi publik/privat është vlerë e mirë kërkon patjetër një organizëm prokurues që synon të përmbushë kërkesat e veta, dhe që është më e mirë se sa opsioni ose opsionet realiste alternative. Për të arritur këtë, do të duhet të kryhet një krahasim sistematik, gjithëpërfshirës dhe tërësor në fazat kyçe të prokurimit (siç citohet në udhëzimet 14 dhe 20). Një kontroll final i tillë duhet të kryhet përpara nënshkrimit të kontratës me ofruesin e preferuar.

Autoriteti prokurues duhet të konfirmojë që kontrata e propozuar ka për qëllim të reflektojë një marrëveshje që nënkupton qëllimet e veta për projektin, mban një çmim të mirë për cilësinë e shërbimive dhe asetëve që do ofrohen, si dhe reflekton një alokim të riskut midis sektorit publik dhe atij privat.

Seksioni 5: Kontrata e Duhur

Udhëzimi 34

Sigurimi i Ofrimit të Shërbimit

Udhëzim

SAI duhet të rishikojë nëse kontrata parashikon provizione në çështje të tilla si matjet e performancës dhe a do të mund shpërblimi i furnizuesit të sigurojnë ofrimin e shërbimit.

Arsyet për Udhëzimin

Nëse kontrata do të jetë e tillë që do të sigurojë ofrimin e shërbimeve të kërkuara, rregullimet për monitorimin e kontratës dhe punën e kontraktorit do të jenë vendimtare. Prandaj SAI duhet të vlerësojë përshtatshmërinë e këtyre rregullimeve. SAI, gjithashtu, ka nevojë të shqyrtojë provizionimet e kontratës së nënshkruar mbi përfundimin dhe dorëzimin, të drejtat e subjektit të audituar për të aksesuar regjistrimet e kontraktorit, regjimin e pagesave, për të vlerësuar nëse kontraktori ka stimuj të mjaftueshëm, dhe sigurinë fizike të subjektit të audituar, për të siguruar se shërbimi do të dorëzohet në standardet e kërkuara. Kur kontrata parashikon për sektorin publik të ndajë fitimet shtesë nga të ardhurat e veprimtarisë së projektit të sektori privat, SAI duhet të shqyrtojë mekanizmat për identifikimin dhe llogaritjen e këtyre fitimeve. SAI duhet të vlerësojë provizionet e kontratës për trajtimin e çdo lloj ndryshimi në kërkesat ndaj subjektit të audituar dhe ndryshime të tjera të çmimit të kontratës, të tilla si indeksimi dhe testimi i tregut. Këto dispozita duhet të përmbajnë procedurë të përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi çmimet dhe çdo aspekt tjetër të ndryshimeve të propozuara.

Seksioni 5: Kontrata e Duhur

Udhëzimi 35

Konfirmimi i Përballueshmërisë

Udhëzim

SAI duhet të identifikojë nëse ka burime për fonde kapitale të nevojshme për të zbatuar projektin dhe për vijimësinë e pagueshmërisë së pagesave sipas kontratës.

Arsyet për Udhëzimin

Marrëveshjet e financim publik/privat dhe koncesionet, përfaqësojnë një angazhim kontraktual që organizmi prokurues të paguajë për shërbimet, me kusht që ato të jenë kryer. Si të tilla, këto marrëveshje zvogëlojnë fleksibilitetin e ardhshëm të organizatës për të menaxhuar shpenzimet e saj. Prandaj, do të ishte e papërgjegjshme për organizatën të hyjë në një marrëveshje të tillë pa e verifikuar nëse do të ketë mundësi për të përdorur fondet e nevojshme për të përmbushur angazhimin kontraktual. Ky verifikim do të duhet të mbulojë çdo kosto kapitale, të cilat mund të lindin në një afat të shkurtër, dhe vijimësinë e angazhimeve afatgjata për të paguar partnerët e sektorit privat. Duhet të kryhet gjithashtu një kontroll mbi ndikimin, nëse ka, e marrëveshjes mbi disponueshmërinë e fondeve për projekte të tjera.

Seksioni 6: Faza operationale

Udhëzim 36

A është aseti i përshtatshëm për qëllimin?

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka vlerësuar nëse asetet e nevojshme si pjesë e marrëveshjes u ofruan në standardin e duhur të cilësisë dhe më pas mbetën të përshtatshme për qëllimet biznesit të subjektit të audituar.

Arsyet për Udhëzimin

Citimi i një provizioni për një aset fiks për vijueshmërinë e ofrimit të shërbimeve është thelbësore për shumicën e projekteve të partneritetit privat-publik. Prandaj një kërkesë kyçe për suksesin e projekteve të tilla, është që sektori privat të ofrojë dhe të mbajë një aset cilësor përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Zakonisht nën partneritetet publike-private, organi shtetëror transferon tek sektori privat risqet që lidhen me dorëzimin me vonesë të aseteve, dështimin për të përmbushur standardet përkatëse të cilësisë dhe çdo rritje në koston e ndërtimit. Prandaj problemet kyçe të çështjeve monetare që SAI duhet të marrë parasysh kur shqyrton rezultatin e ndërtimit të asetit, është nëse me të vërtetë aseti është dorëzuar në kohë dhe me cilësinë e duhur me specifikimet kontraktuale të respektuara. Në rast se do të kishte ndonjë rritje të kostove të ndërtimit që përballuara nga subjekti i audituar, atëherë SAI duhet të vlerësojë nëse rritje të tilla të pagesave ishin të justifikuara, për shembull, subjekti i audituar mund të ketë kërkuar ndryshime në dizenjon e asetit të cilat e rritën koston e kontraktorit privat.

Nëse shërbimi i kërkuar po hyn ndërkohë në funksion, për shembull, rruga hapet për trafikun e lëvizjeve ose spitali hapet për pacientët, SAI duhet të kërkojë evidenca që subjekti i adudituar sigurohet se kompania e sektorit privat po mirëmban asetin në standartet e kërkuara në kontratë.

Seksioni 6: Faza operacionale

Udhëzimi 37

Dispozitat e shërbimit përmbushin nevojat e biznesit.

Udhëzim

SAI duhet të rishikojë nëse shërbimet e kërkuara si pjesë e kontratës po ofrohen sipas standarteve të duhura të cilësisë dhe mbeten në linjë me nevojat e biznesit të subjektit të audituar.

Arsyet për Udhëzimin

Një përcaktues vendimtar nëse një marrëveshje financimi publik/privat po ofron vlerë për parane, është që autoriteti prokures po e merr atë shërbim nga projekti që përmbush nevojat e biznesit të tij.

Në fillim të ofrimit të shërbimit nga kontraktori i sektorit privat, çështjet kryesore që SAI duhet të kontrollojë janë nëse shërbimet po ofrohen dhe pagesa është në vijimësi me provizionimet e kontratës. SAI duhet të kërkojë siguri që raportimi i performancës së shërbimeve dhe përlogaritja e pagesave, zakonisht i quajtur Sistemi i Matjes së Performancës SMP (ose *PMS-Performance Measurement System*), reflekton në mënyrë të detajuar të gjitha shërbimet e kërkuara në kontratë dhe performancën aktuale nga kontraktori.

Ndërkohë që marrëveshjet e financimit publik/privat mund të përfshijnë ofrimin e shërbimeve për periudha të zgjatura kohore (nuk është e rrallë 30 vjet ose më shumë), subjekti i audituar nevojitet të sigurojë se rishikon në mënyrë periodike shërbimet e kërkuara në kontratë, duke përcaktuar nëse ato janë akoma në përputhje me nevojat aktuale të biznesit të tij, dhe të negociojë ndryshimet aty ku është e aplikueshme. Në këtë mënyrë SAI, duhet të konfirmojë nëse subjekti i audituar po kryen një analizë të tillë.

Seksioni 6: Faza Operacionale

Udhëzimi 38

Marrëveshja vazhdon të jetë vlerë për paranë

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar rishikon në mënyrë periodike progresin e marrëveshjeve të financimit publik/privat dhe të vlerësojë nëse ato vazhdojnë të ofrojnë vlerë për paranë.

Arsyet për Udhëzimin

Subjekti i audituar duhet të rishikojë në mënyrë periodike progresin e projektit për dy arsye kryesore; për të vlerësuar nëse marrëveshja vazhdon të ofrojë vlerë të vazhdueshme për paranë, dhe nëse mënyra e financimit publik/privat është duke ofruar rezultate më të mira se mënyrat e tjera alternative të prokurimeve. Si pjesë e arsyetimit të fundit, SAI duhet të konfirmojë që po ruhet përbalueshmëria e marrëveshjes, që palët e interesuara janë të kënaqura me progresin e projektit, që po materializohen rezultatet e pritura, dhe aty ku identifikohet performancë e ulët, ka filluar një vlerësim i vazhdueshmërisë së marrëveshjes. Vlerësimi nëse mënyra e financimit publik/privat ofron rezultate më të mira në krahasim me alternativat e tjera, duhet të udhëhiqet nga subjekti i audituar, në mënyrë që të ndërtohet një bazë të dhënash mbi mënyrën e prokurimit dhe ofrimit që funksionon më mirë.

Seksioni 6: Faza Operacionale

Udhëzimi 39

Ruajtja e strukturave drejtuese dhe bashkëpunuese

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse audituesi ka strukturat e duhura drejtuese për projektin dhe ruan marrëdhënie të mira me kontraktorin/ët

Arsyet për Udhëzimin

Strukturat drejtuese janë kyçe për llogaridhënien e palëve të përfshira dhe si të tilla kanë një impakt të madh në efektivitetin e marrëveshjes. Marrëdhënie të mira midis palëve, ndihmojnë të gjitha palët në arritjen e objektivave të tyre.

Seksioni 6: Faza Operacionale

Udhëzimi 40

Ruajtja e stafit të menaxhimit të kontratës

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka ruajtur një personel të aftë dhe me njohuri të mjaftueshme për të menaxhuar kontratat e financimit publik/privat.

Arsyet për Udhëzimin

Cilado qoftë vlera potenciale për paranë të një marrëveshje të financimit publik/privat kur ajo është firmosur, menaxhimi i mëvonshëm i dobët i kontratës mund të rezultojë në kosto më të larta, burime të humbura, performancë të dëmtuar dhe kritika të mundshme nga palët e interesuara. Prandaj, SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka ngritur një personel të financuar mjaftueshëm dhe me eksperiencën e nevojshme për të menaxhuar në mënyrë inteligjente kontratën. Subjekti i audituar duhet të kuptojë se çfarë personeli ka caktuar sektori privat dhe më tej të përshtasi përgjegjësitë. Personeli i vendosur nga subjekti ka nevojë për të

kuptuar kontratën dhe përmbajtjen së saj, të kuptojë biznesin dhe objektivat, të ketë aftësi të forta negociimi.

Subjekti i audituar duhet të mirëmbajë eksperiencën e stafit gjatë periudhës së kontratës dhe të rishikojë rregullisht performancën e tij në menaxhimin e kontratës, si dhe të rivlerësojë periodikisht vlerën për para të ofruar nga kontrata. Si rezultat i mësimëve të identifikuara në rishikime të tilla, SAI duhet të shikojë për evidenca që subjekti i audituar ka kërkuar përmirësime në kontratën aktuale dhe pasardhëse, kur është e mundur.

Paqartësia se kush është përgjegjës për çfarë mund të rezultojë gjithashtu në menaxhim joefektiv të një kontrate. Prandaj, SAI duhet të shqyrtojë nëse detyrat dhe përgjegjësitë për menaxhimin e kontratës, si dhe procedurat që do të ndiqen, të jenë përcaktuara qartë. Megjithatë, zbatimi korrekt i procedurave në përputhje me përgjegjësitë e dhëna nuk është i mjaftueshëm për të garantuar vlerën për para. Ofrimi i kërkesave kontraktuale varet edhe nga individët e përfshirë. Menaxhimi i marrëdhënieve mes subjektit të audituar dhe kontraktorit gjithashtu do të duhet të shqyrtohet nga SAI.

Kapitulli 6: Faza operationale

Udhëzimi 41

Ruajtia e alokimit të duhur të riskut

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse alokimi i riskut ndërmjet palëve private dhe publike mbetet optimal gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së projektit.

Arsyet për Udhëzimin

Alokimi i një riskut të veçantë ndaj palës që ka mundësi më të mirë të menaxhimit të tij, është një çelës për të marrë vlerën për para nga një projekt i financimit publik/privat. Alokimi i duhur dhe menaxhimi i suksesshëm i riskut duhet të mbahet

nën kontroll gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. SAI duhet të vlerësojë se alokimi i riskut mbetet optimal dhe se subjekti i audituar duhet menaxhojë çdo risk që mund të rezultojë.

Seksioni 6: Faza operacionale

Udhëzimi 42

Trajtimi kontabël i përshtatshëm

Udhëzim

SAI duhet të rishikojë trajtimin kontabël për asetin e dorëzuar sipas marrëveshjes së financimit publik/privat dhe të vlerësojë nëse përputhet me rregullat dhe udhëzimet aktuale të kontabilitetit.

Arsyet për Udhëzimin

Pasi projekti bëhet operacional, transferimi aktual i riskut mund të ndryshojë nga ai i parashikuar fillimisht kur projekti ishte në fazën e zhvillimit. Çdo ndryshim faktik në transferimin e riskut, mund të ndikojë në vlerësim sesi asetit është kontabilizuar në llogaritë e subjektit të audituar. Prandaj SAI duhet të konfirmojë, kur është e rëndësishme, që audituesit e jashtëm të entitetit të audituar (nëse jo vetë SAI), kanë rivlerësuar risqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin pasi është plotësisht funksional dhe janë të kënaqur me trajtimin kontabël përkatës.

Në mënyrë të ngjashme, SAI duhet të konfirmojë ku kanë ndryshuar standardet dhe udhëzimet e kontabilitetit për projektet e zhvilluara nga partneriteti publik/privat, dhe nëse subjekti i audituar ka përshtatur trajtimin e tij kontabël në përputhje me rrethanat.

Seksioni 6: Faza operacionale

Udhëzimi 43

Menaxhimi i përfundimit të kontratës

Udhëzim

SAI duhet të shqyrtojë nëse subjekti i audituar ka planifikuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive daljen e tij nga kontrata me përfundimin e saj.

Arsyet për Udhëzimin

Risku i fundit i vlerës për para vjen në përfundimin e një kontrate, kur menaxhimi i dobët mund të ndikojë negativisht në vlerën për para të çdo lloj marrëveshjeje të mëvonshme, që subjekti i audituar lidh për ofrim shërbimi. Është e rëndësishme, pra, që subjekti i audituar të kryejë planifikim të përshtatshëm të përfundimit të kontratës, në mënyrë që të mund të marr vendime të informuara në lidhje me opsionet në dispozicion të tij në përfundimin e kontratës, dhe pastaj të menaxhojë daljen siç duhet.

Prandaj SAI duhet të vlerësojë nëse subjekti ka identifikuar se si do të dorëzohen shërbimet pasi përfundon kontrata, çfarë risqesh mund të materializohen lidhur me dorëzimin e dispozitave të shërbimit dhe çfarë planesh ka për menaxhimin e këtyre risqeve.

Fjalori

Termtat	Përkufizimi
Çëshjte biznesi	Dokument që përshkruan një propozim konkret, duke mbuluar aspektet e tij pozitive dhe negative, e duke siguruar një argument bindës se si dhe pse propozimi duhet të zbatohet.
Tensionet e konkurrencës	Situata, në të cilën konkurrentët janë të detyruar për të bërë ofertat e mallrave/shërbimeve/ofertave, tërheqëse për organizmin prokurues, duke bërë të mundur që të mos humbin pozicionin e tyre me konkurrentët rivale, duke arritur në një marrëveshje më të mirë.
Konflikti i interesit	Situata në të cilën një person i caktuar ose një organizatë është duke vepruar në dy kapacitete, qëllimet apo interesat e të cilave bien në kundërshtim. Ky term mund të përdoret gjithashtu për të përshkruar një mundësi për dikë që të keqpërdorë pozitën dhe autoritetin për përfitime personale.
Dorëzimi	Në kuadër të udhëzimeve, mënyrat e ofrimit të një shërbimi, para se të lidhet një kontratë.
Vlerësimi i strukturës	Paracaktimi i një sërë kriteresh për arritjen e objektivave të projektit, të përdorura për të siguruar qëndrueshmëri kur vlerësohen ofertat e pranuar më pas, gjatë procesit të tenderimit.
Modeli financiar	Mjete analitike (p.sh. spreadsheets) të projektuara për të treguar rezultatin financiar të një grupi të veçantë të kostove të vlerësuara, të ardhurave dhe pagesave fikse dhe kapitalit për dhënien e një shërbimi me kalimin e kohës.
Strukturat qeverisëse	Sistemi ekzistues i mbikëqyrjes që mundëson menaxhimin të mbajë kontrollin mbi projektin, duke përfshirë ndarjen e përgjegjësiive të menaxhimit, proceset dhe sistemet për raportimin te menaxhimi.
Faza operacionale	Periodha e kohës pas nënshkrimit të kontratës gjatë së cilës operatori i sektorit privat siguron mallrat/shërbimet siç përcaktohet nga kontrata, d.m.th. jetëgjatësia e kontratës.

Sistemi i matjes së performances	Procesi me të cilin autoriteti prokurues vlerëson se sa mirëoperatori i sektorit privat po përmbush kërkesat e kontraktuara, duke matur performancën e standardeve të përcaktuara për të gjitha aspektet përkatëse të marrëveshjes.
Ofruesi i preferuar	Ofruesi i përzgjedhur nga organizmi prokurues si pala me të cilin ai dëshiron të nënshkruajnë një kontratë, subjekt për përfundimin e negociatave dhe marrëveshjeve ligjore. Në fazat e mëvonshme të procesit të tenderimit, organi i prokurues do të negociojë vetëm me ofruesin e preferuar.
Krahasuesit e sektorit privat	Një vlerësim se sa do të kushtojë projekti nëse përdoren metodat tradicionale të prokurimit. Kjo përdoret për të ndihmuar në përcaktimin nëse financat private ofrojnë vlerën më të mirë për para, krahasuar me prokurimin tradicional.
Alokimi i riskut	Marrëveshja ndërmjet palëve në një marrëveshje të financimit publik/privat ose koncesioneve, e cila përcakton se cilat palë janë përgjegjëse për mbartjen e pasojave financiare që mund të rezultojnë, duke minimizuar mundësinë që të lind një ngjarje negative, dhe sesi mund të zbutet kjo situatë.
Niveli i riskut	Një vlerësim për rëndësinë e risqeve për tu parashikuar nga një palë. Kombinon mundësinë e një risku të caktuar që vjen me ndikimin e këtij risku të veçantë.
Transferimi i riskut	Kalimi i riskut të mbartur nga organi prokurues në ofruesin e shërbimit të sektorit privat.
Modeli i kostove të nevojshme	Një llogaritje e pavarur e kostove të pritshme të ofrimit të së njëjtës zgjidhje teknike siç është propozuar nga ofruesi.
Palët e interesuara	Çdo person, grup, organ ose organizatë që është i përfshirë ose i prekur nga marrëveshjet e propozuara të financimit publik/privat dhe koncesioneve, dhe për këtë arsye ka një interes në suksesin e saj.

Procesi i tenderimit	Praktika e reklamimit, e më pas e marrjes dhe vlerësimit të ofertave nga kompani të ndryshme të sektorit privat, për të operuar në fushën e shërbimeve të marrëveshjeve të financimit publik/privat dhe koncesioneve, me qëllim që të sigurojnë vlerën më të madhe të parasë.
Strategjia e tenderit	Plani i detajuar që përshkruan se si procesi i tenderimit duhet kryer, në mënyrë që të arrihet rezultati sa më i mirë i mundshëm. Përfshin numrin e raundeve dhe ofertave të angazhuara, një afat kohor dhe një plan për komunikim optimal me ofruesit.
Prokurimi Tradicional	Një kontratë në të cilën klienti thjesht paguan kontraktin për sigurimin e një aseti. Asete të tilla janë zakonisht të paguara plotësisht në përfundimin e tyre. Ruajtja e këtyre aseteve është trajtuar në kontrata të veçanta, ndërsa operimi i tyre mbetet përgjegjësi e sektorit publik.
Vlera për parinë	Arritja e kombinimit të kostos gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit dhe cilësia e përballeshme, e cila i plotëson më së miri kërkesat e organizmit prokurues.
Ndryshime të kontratës	Një marrëveshje mes të gjitha palëve në një kontratë për të ndryshuar disa nga kushtet e përcaktuara në kontratën origjinale, me dispozitën shtesë të kontratës së parë



**KODI I
TRANSPARENCĒS
FISKALE**

A. PARIMET E TRANSPARENCËS FISKALE

I. Raportimi fiskal

Raportet fiskale duhet të sigurojnë një pamje të besueshme, në kohë, të rëndësishëm dhe gjithëpërfshirëse të performancës e të pozicionit financiar të qeverisë

1.1 Fusha e mbulimit: Raportimi fiskal duhet të sigurojë një pajme gjithëpërfshirëse të aktiviteteve fiskale për sektorin publik dhe nënsektorët e tij, sipas standardeve ndërkombëtare.

- 1.1.1 **Institucionet:** Raportet fiskale përfshijnë të gjithë entitetet e angazhuara në aktivitetin publik sipas standardeve ndërkombëtare
- 1.1.2 **Asetet:** Raportet fiskale përfshijnë bilancet e aseteve publike, vlerën e detyrimeve dhe vlerën neto.
- 1.1.3 **Likuiditetet:** Raportimi fiskal përfshin të gjithë të ardhurat publike, shpenzimet dhe financimin.
- 1.1.4 **Stimulimi fiskal:** Në mënyrë të rregullt qeveritë duhet të bëjnë të ditur dhe të menaxhojnë humbjen që vjen nga stimulimi përmes reduktimit të detyrimeve tatimore me qëllim stimulimin.

1.2 Frekuenca dhe Periodiciteti: Raportet fiskale duhet të publikohen në mënyrë frekvente, të rregullt dhe në mënyrë periodike në kohë.

- 1.2.1 **Frekuenca e Raportimit Vjetor:** Raportet fiskale vjetore duhet të publikohen në bazë të rregullt dhe frekvente.
- 1.2.2 **Periodiciteti i Pasqyrimit Financiar Vjetor:** Pasqyrat vjetore finale apo të audituara duhet të publikohen periodikisht.

1.3 Cilësia: Informacioni në raportet fiskale duhet të jetë i rëndësishëm, ndërkombëtarisht i krahasueshëm, konsistent me aspektin e brendshëm dhe historik.

- 1.3.1 **Klasifikimi:** Raportimi fiskal klasifikon informacionin në mënyrë që ta bëjë të qartë përdorimin e burimeve publike dhe të lehtësojë krahasimin ndërkombëtar.
- 1.3.2 **Konsistenca me Aspektin e Brendshëm:** Raportet fiskale janë konsistent me aspektin e brendshëm dhe përfshin ripërshtatjen me masat alternative të agregateve fiskal përmbledhës.
- 1.3.3 **Revizioni Historik:** Revizionimi më i rëndësishëm me statistikat fiskale historike publikohet dhe shpjegohet.

*1.4 **Integriteti:** Statistikat fiskale dhe pasqyrat financiare duhet të jenë të besueshme, subjekt i auditimit të hollësishëm të jashtëm dhe që të lehtësojnë llogaridhënien.*

- 1.4.1 **Integriteti i Statistikave:** Statistikat fiskale përpilohen dhe paraqiten në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- 1.4.2 **Auditi i Jashtëm:** Pasqyrat financiare vjetore janë subjekt i një auditimi të publikuar nga instituti suprem i auditimit, i pavarur, i cili vlerëson besueshmërinë e tyre.
- 1.4.3 **Krahasueshmëria e të Dhënave Fiskale:** Parashikimet fiskale, buxhetet dhe raportet fiskale paraqiten në një bazë të krahasueshme dhe me ndonjë devijim të shpjeguar.

II.Parashikimi Fiskal dhe Buxhetimi

Buxhetet dhe parashikimet fiskale të tyre duhet të sigurojnë një paraqitje të saktë të objektivave buxhetore dhe qëllimet e politikave të qeverisë dhe të jenë një projeksion i besueshëm, në kohë dhe gjithpërfshirës i evolucionit të financave publike.

*1.1 **Gjithëpërfshirja:** Parashikimet fiskale dhe buxhetet duhet të sigurojnë një pamje gjithëpërfshirëse të perspektivës fiskale.*

- 1.1.1 **Uniciteti i Buxhetit:** Të ardhurat, shpenzimet dhe financimi i qeverisë qendrore prenzatohen në një dokument buxheti përmbledhës dhe autorizohen nga legjislatura.

- 1.1.2 **Parashikimet Makroekonomike:** Projektionet buxhetore bazohen në parashikime makroekonomike gjithpërfshirëse, të cilët publikohen dhe shpjegohen.
- 1.1.3 **Kuadri i Buxhetimit Afatmesëm:** Dokumentimi i buxhetit përfshin shpjegimin e konstatimeve përtej parashikimit dhe projeksionin e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe mënyrën e financimit përgjatë periudhës afatmesme mbi të njëjtën bazë të buxhetimit vjetor.
- 1.1.4 **Projektet e Investimeve:** Qeveria në mënyrë të rregullt publikon detyrimet e saj financiare pjesë e projekteve të investimeve disavjeçare dhe bën subjekt të analizës kosto përfitim të gjithë projektet madhore, të hapura dhe mbi bazën e tenderimit konkurrues.

1.2 Kuadri Ligjor: *Fuqia dhe përgjegjësia e degëve ekzekutive dhe legjislative të qeverisë në procesin e buxhetimit duhet të përcaktohet me ligj, buxheti duhet të prezantohet, debatohet dhe të aprovohet duke lënë kohë të përshtatshme.*

- 1.2.1 **Legjislacioni Fiskal:** Kuadri ligjor përcakton qartë orarin e përgatitjes dhe miratimit të buxhetit, përmbajtjet e rëndësishme për dokumentimin e buxhetit, si dhe fuqitë dhe përgjegjësitë për ekzekutivin dhe legjislativin në procesin e buxhetimit.
- 1.2.2 **Përshtatshmëria në Kohë e Dokumentave të Buxhetit:** Ligjvënësve dhe publikut, në mënyrë të vazhdueshme, i lihet kohë e përshtatshme për të vëzhguar me imtësi dhe për të aprovuar buxhetin vjetor.

1.3 Orientimi i Politikave: *Parashikimet dhe buxhetet fiskale duhet të prezantohen në një mënyrë që të lehtësojë analizën dhe llogaridhënien e vlerësimit të politikave.*

- 1.3.1 **Objektivat e Politikave Fiskale:** Qeveria shprehet dhe raporton me objektiva të qarta dhe të matshme për financat publike.
- 1.3.2 **Informacioni mbi Performancën:** Dokumentimi mbi buxhetet siguron informacion përsa i përket objektivave dhe rezultateve të arritura sipas secilës nga zonat e politikave kryesore qeveritare.
- 1.3.3 **Pjesmarrja e Publikut:** Qeveria i siguron publikut një përmbledhje të aksesueshme të pasojave të politikave të buxhetit dhe një mundësi për të marrë pjesë në përgatitjen e buxhetit.

1.4 Kredibiliteti: Parashikimet fiskale dhe ekonomike, dhe buxhetet duhet të jenë të besueshme.

- 1.4.1 **Vlerësim i Pavarur:** Parashikimet ekonomike dhe fiskale të qeverisë dhe performanca e saj janë subjekt i vlerësimit të pavarur.
- 1.4.2 **Buxheti Shtesë:** Çdo ndryshim i rëndësishëm nga buxheti i aprovuar autorizohet nga legjislativi.
- 1.4.3 **Ripërshatja e Parashikimeve:** Dokumentimi i buxhetit dhe ndonjë ndryshim pasues duhet të shpjegojnë ndryshimet e rëndësishme nga parashikimi fiskal i mëparshëm i qeverisë, duke evidentuar ndikimin fiskal të politikave të reja nga parashikimi bazë.

III. Analiza e Riskut Fiskal dhe Menaxhimi

Qeveritë duhet të bëjnë të ditur, të analizojnë dhe menaxhojnë riskun e financave publike dhe të sigurojnë koordinim efektiv të vendim marrjes fiskale për të gjithë sektorin publik.

3.1 Prezantimi i riskut dhe analizimi: Qeveritë duhet të publikojnë raporte përmbledhëse periodike mbi riskun e perspektivave fiskale.

- 3.1.1 **Risku Makroekonomik:** Qeveria raporton për atë se si rezultati fiskal mund të ndryshojë nga parashikimet e linjës bazë si pasojë e supozimeve makroekonomike.
- 3.1.2 **Risku Fiskal Specifik:** Qeveria siguron një raport përmbledhës periodik mbi riskun specifik të parashikimeve të saj fiskale.
- 3.1.3 **Analiza e Qëndrueshmërisë Fiskale Afatgjatë:** Qeveria publikon periodikisht projeksionin e evolucionit të financave publike për periudhën afatgjatë.

3.2 Prezantimi i riskut dhe analizimi: Qeveritë duhet të publikojnë raporte përmbledhëse periodike mbi riskun e perspektivave fiskale.

- 3.2.1 **Provizionet buxhetore:** Buxheti ka alokime transparente dhe të përshtatshme për fonde provizioni që evidentohen përgjatë ekzekutimit të buxhetit.
- 3.2.2 **Menaxhimi i Aseteve dhe i Detyrimeve:** Risqet në lidhje me asetet dhe detyrimet paraqiten dhe menaxhohen.

- 3.2.3 Garancitë:** Garancitë për ekspozimin ndaj riskut të qeverisë paraqiten në mënyrë të rregullt dhe autorizohen me ligj.
- 3.2.4 Partneriteti Publik Privat:** Detyrimet për partneritetin publik privat paraqiten në mënyrë të rregullt dhe menaxhohen aktivisht.
- 3.2.5 Ekspozimi i Sektorit Financiar:** Ekspozimi fiskal potencial i qeverisë ndaj sektorit financiar analizohet, paraqitet dhe menaxhohet.
- 3.2.6 Burimet Natyrore:** Interesat e qeverisë në asetet e burimeve natyrore të konsumueshme dhe shfrytëzimi i tyre vlerësohet, paraqitet dhe menaxhohet.
- 3.2.7 Risku i Mjedisit:** Ekspozimi fiskal potencial ndaj katastrofave natyrore dhe risqeve të tjera kryesore të mjedisit vlerësohen, paraqiten dhe menaxhohen.

3.3 Koordinimi Fiskal: *Relacionet dhe performanca fiskale të sektorit publik duhet të analizohen, paraqiten dhe të koordinohen.*

- 3.3.1 Njësitë nënqeveritare:** Informacioni gjithpërfshirës mbi kushtet financiare dhe performancën e njësive nënqeveritare, në mënyrë individuale dhe si sektor i konsoliduar, mblidhen dhe publikohen.
- 3.3.2 Koorporatat publike:** Qeveria në mënyrë të rregullt publikon informacion gjithpërfshirës mbi performancën financiare të korporatave publike, duke përfshirë dhe ndonjë aktivitet gati – fiskal të ndërmarrë nga ato.

B. PËRSHKRIM NË PRINCIM I PRAKTIKAVE BAZIKE, TË MIRA DHE TË AVANCUARA

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
1	Raportimi fiskal	Raportet fiskale duhet të sigurojnë një vështrim të besueshëm, në kohë, të rëndësishëm dhe gjithpërfshirës të performancës dhe pozicionit financiar të qeverisë			
1.1	Fusha	Raportet fiskale duhet të sigurojnë një vështrim gjithpërfshirës të performancës të aktivitetit financiar të sektorit publik dhe të nënsektorëve të saj, sipas standardeve ndërkombëtare.			
1.1.1	Institucionet	Raportet fiskale përfshijnë të gjithë entitetet e angazhuara në aktivitetin publik sipas standardeve ndërkombëtare	Raportet fiskale konsolidojnë të gjithë entet qendrore qeveritare sipas standardeve ndërkombëtare	Raportet fiskale konsolidojnë të gjithë entet qendrore qeveritare dhe raportojnë për çdo nënsektor sipas standardeve ndërkombëtare	Raportet fiskale konsolidojnë të gjithë entet e sektorit publik dhe raportojnë për çdo nënsektor sipas standardeve ndërkombëtare
1.1.2	Asetet	Raportet fiskale përfshijnë një pasqyrë kontabël të asetëve publike, detyrimeve dhe vlerën neto	Raportet fiskale përfshijnë arkën dhe llogarinë bankare, dhe të gjithë borxhin	Raportet fiskale përfshijnë të gjithë asetet financiare dhe detyrimet	Raportet fiskale përfshijnë të gjithë asetet financiare dhe jo financiare, dhe detyrimet dhe pasurinë neto
1.1.3	Likuiditetet	Raportet fiskale përfshijnë të gjithë të ardhurat publike, shpenzimet dhe financimin	Raportet fiskale përfshijnë të ardhurat në lekë, shpenzimet dhe financimin	Raportet fiskale përfshijnë lëvizjet në para, të ardhurat në avancë, shpenzimet dhe financimin	Raportet fiskale përfshijnë lëvizjet në para, të ardhurat në avancë, shpenzimet dhe financimin, dhe lëvizje të tjera ekonomike
1.1.4	Stimulimi fiskal	Në mënyrë të rregullt qeveritë duhet të bëjnë të ditur dhe të menaxhojnë humbjen që vjen nga stimulimi përmes reduktimit të detyrimeve tatimore me qëllim stimulimin.	Humbja e vlerësuar e të ardhurave nga stimulimi fiskal publikohet të paktën në mënyrë vjetore	Humbja e vlerësuar e të ardhurave nga stimulimi fiskal vlerësohet sipas sektorëve apo fushave të politikave dhe publikohet të paktën në mënyrë vjetore	Humbja e vlerësuar e të ardhurave nga stimulimi fiskal vlerësohet sipas sektorëve apo fushave të politikave dhe publikohet të paktën në mënyrë vjetore. Ka një kontroll mbi objektivat buxhetore për masën e shumës së stimulimit fiskal

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
1.2	Frekuenca dhe Periodiciteti	Raportet fiskale duhet të publikohen në mënyrë frekvente, të rregullt dhe në mënyrë periodike në kohë.			
1.2.1	Frekuenca e raportimit vjetor	Raportet fiskale vjetore publikohen në mënyrë frekvente dhe të rregullt	Raportet fiskale vjetore publikohen në mënyrë katërmujore, brenda një katërmujori	Raportet fiskale vjetore publikohen në mënyrë katërmujore, brenda një muaji	Raportet fiskale vjetore publikohen në mënyrë mujore, brenda një muaji
1.2.2	Periodiciteti i Pasqyrimit Financiar Vjetor	Pasqyrat vjetore finale apo të audituara duhet të publikohen periodikisht	Pasqyrat vjetore finale apo të audituara duhet të publikohen brenda 12 muajve nga fundi i vitit financiar	Pasqyrat vjetore finale apo të audituara duhet të publikohen brenda 9 muajve nga fundi i vitit financiar	Pasqyrat vjetore finale apo të audituara duhet të publikohen brenda 6 muajve nga fundi i vitit financiar
1.3	Cilësia	Informacioni në raportet fiskale duhet të jetë i rëndësishëm, ndërkombëtarisht i krahasueshëm, konsistent me aspektin e brendshëm dhe historik			
1.3.1	Klasifikimi	Raportimi fiskal klasifikon informacionin në mënyrë që ta bëjë të qartë përdorimin e burimeve publike dhe të lehtësojë krahasimin ndërkombëtar	Raportimi fiskal përfshin klasifikimin ekonomik dhe administrativ konsistent me standardet ndërkombëtare kur janë të aplikueshme	Raportimi fiskal përfshin klasifikimin administrativ, ekonomik dhe funksional konsistent me standardet ndërkombëtare kur janë të aplikueshme	Raportimi fiskal përfshin klasifikimin administrativ, ekonomik, funksional dhe të programit konsistent me standardet ndërkombëtare konsistent me standardet ndërkombëtare kur janë të aplikueshme
1.3.2	Konsistenca me Aspektin e Brendshëm	Raportet fiskale janë konsistent me aspektin e brendshëm dhe përfshin ripërshtatjen me masat alternative të agregateve fiskal përmbledhës	Raportet fiskale përfshijnë të paktën një nga ripërshtatjet e mëposhtme: (i) bilanci fiskal dhe i financimit, (ii) borxhi i emetuar dhe aktual, ose (iii) financimi dhe ndryshimi në stokun e borxhit	Raportet fiskale përfshijnë të paktën dy nga ripërshtatjet e mëposhtme: (i) bilanci fiskal dhe i financimit, (ii) borxhi i emetuar dhe aktual, ose (iii) financimi dhe ndryshimi në stokun e borxhit	Raportet fiskale përfshijnë të paktën tre nga ripërshtatjet e mëposhtme: (i) bilanci fiskal dhe i financimit, (ii) borxhi i emetuar dhe aktual, dhe (iii) financimi dhe ndryshimi në stokun e borxhit

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
1.3.3	Revizioni Historik	Revizionimi më i rëndësishëm me statistikat fiskale historike publikohet dhe shpjegohet	Revizionet kryesore në lidhje me statistikat fiskale historike raportohen	Revizionet kryesore në lidhje me statistikat fiskale historike raportohen me një shpjegim për secilin revizion kryesor	Revizionet kryesore në lidhje me statistikat fiskale historike raportohen me një shpjegim për secilin revizion kryesor dhe duke i shoqëruar me tabela krahasuese mes serive kohore të reja dhe të vjetra
1.4	Integriteti	Statistikat fiskale dhe pasqyrat financiare duhet të jenë të besueshme, subjekt i auditimit të hollësishëm të jashtëm dhe që të lehtësojnë llogaridhënien			
1.4.1	Integriteti Statistikor	Statistikat fiskale përpilohen dhe paraqiten në përputhje me standardet ndërkombëtare	Statistikat fiskale paraqiten në përputhje me standardet ndërkombëtare	Statistikat fiskale përpilohen nga një agjensi specifike qeveritare dhe paraqiten në përputhje me standardet ndërkombëtare	Statistikat fiskale përpilohen nga një trupë e pavarur profesionale dhe paraqiten në përputhje me standardet ndërkombëtare
1.4.2	Auditi i Jashtëm	Pasqyrat financiare vjetore janë subjekt i një auditimi të publikuar nga instituti suprem i auditimit i pavarur, i cili vlerëson besueshmërinë e tyre	Instituti suprem i auditimit i pavarur publikon një raport auditimi mbi besueshmërinë e pasqyrave financiare vjetore të qeverisë	Instituti suprem i auditimit i pavarur publikon një raport auditimi ku citohet nëse pasqyrat financiare vjetore të qeverisë prezantojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit të saj financiar, dhe përtej një opinionit negativ apo pamjaftueshmëri të dhënies së opinionit të auditimit	Instituti suprem i auditimit i pavarur publikon një raport auditimi në përputhje me standardet ndërkombëtare ku citohet nëse pasqyrat financiare vjetore të qeverisë prezantojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit të saj financiar, dhe përtej të kualifikimeve kryesore
1.4.3	Krahasueshmëria e të dhëneve	Parashikimet fiskale, buxhetet dhe raportet fiskale paraqiten në një bazë të krahasueshme dhe me ndonjë devijim të shpjeguar	Të paktën një raport fiskal përgatitet në të njëjtën bazë si buxheti/parashikimi fiskal	Buxheti/parashikimi fiskal dhe konstatimet përtej parashikimit janë të krahasueshme, plus rezultati është përputhur me ose statistikat fiskale ose llogaritë finale	Buxheti/parashikimi fiskal dhe konstatimet përtej parashikimit janë të krahasueshme, plus rezultati është përputhur si me statistikat fiskale ashtu dhe me llogaritë finale

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
2	BUXHETIMI DHE PARASHIKIMI FISKAL	Buxhetet dhe parashikimet fiskale të tyre duhet të sigurojnë një paraqitje të saktë të objektivave buxhetore dhe qëllimit e politikave të qeverisë dhe të jenë një projeksion i besueshëm, në kohë dhe gjithpërfshirës i evolucionit të financave publike.			
2.1	<i>Gjithpërfshirja</i>	<i>Parashikimet fiskale dhe buxhetet duhet të sigurojnë një pamje gjithpërfshirëse të perspektivës fiskale.</i>			
2.1.1	Uniciteti i buxhetit	Të ardhurat, shpenzimet dhe financimi i qeverisë qendrore prezatohen në një dokument buxheti përmbledhës dhe autorizohen nga legjislatura	Dokumentimi i buxhetit përfshin të gjithë të ardhurat e brendshme bruto nga taksat, shpenzimet dhe financimin nga ministritë, agjensitë dhe fondet jashtë buxhetit	Dokumentimi i buxhetit përfshin të gjithë të ardhurat e brendshme bruto nga taksat dhe jo taksat, shpenzimet dhe financimin nga ministritë, agjensitë dhe fondet jashtë buxhetit	Dokumentimi i buxhetit përfshin të gjithë të ardhurat bruto të brendshme dhe të jashtme, dhe financimin nga ministritë, agjensitë, fondet jashtë buxhetit dhe fondet e sigurimeve shoqërore
2.1.2	Parashikimi makroekonomik	Projeksionet buxhetore bazohen në parashikime makroekonomike gjithpërfshirëse, të cilët publikohen dhe shpjegohen.	Dokumentimi i buxhetit përfshin parashikimin e variablave makroekonomik kryesor	Dokumentimi i buxhetit përfshin parashikimin e variablave makroekonomik kryesor dhe supozimet e tyre përkatëse	Dokumentimi i buxhetit përfshin parashikimin dhe shpjegimin e variablave makroekonomik kryesor dhe të komponentëve të tyre si dhe supozimet e tyre përkatëse
2.1.3	Kuadri i Buxhetimit Afatmesëm	Dokumentimi i buxhetit përfshin shpjegimin e konstatimeve përtej parashikimit dhe projeksionin e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe mënyrën e financimit përgjatë periudhës afatmesme mbi të njëjtën bazë të buxhetimit vjetor	Dokumentimi i buxhetit përfshin shpjegimin e konstatimeve përtej parashikimit të të dy viteve pararendëse si dhe projektimet afatmesme të të ardhurave agregate, shpenzimeve, dhe financimit	Dokumentimi i buxhetit përfshin shpjegimin e konstatimeve përtej parashikimit të të dy viteve pararendëse si dhe projektimet afat mesme të të ardhurave agregate, shpenzimeve, dhe financimit sipas kategorive ekonomike	Dokumentimi i buxhetit përfshin shpjegimin e konstatimeve përtej parashikimit të të dy viteve pararendëse si dhe projektimet afat mesme të të ardhurave, shpenzimeve, dhe financimit sipas kategorive ekonomike dhe sipas ministrive ose programeve

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
2.1.4	Projektet e Investimeve	Qeveria në mënyrë të rregullt publikon detyrimet e saj financiare pjesë e projekteve të investimeve disavjeçare, dhe bën subjekt të analizës kosto përfitim të gjithë projektet madhore, të hapura dhe mbi bazën e tenderimit konkurrues	Një ndër to aplikohet, (i) qeveria në mënyrë të rregullt publikon vlerën e të gjithë detyrimeve totale pjesë e projekteve të investimeve disa vjeçare, (ii) bën subjekt të analizës kosto përfitim të gjithë projektet madhore përpara aprovimit, (iii) kërkon që të gjithë projektet kryesore të kontraktohen përmes tenderit konkurrencial dhe të hapur	Dy ndër to aplikohen, (i) qeveria në mënyrë të rregullt publikon vlerën e të gjithë detyrimeve totale pjesë e projekteve të investimeve disa vjeçare, (ii) bën subjekt të analizës kosto përfitim të gjithë projektet madhore përpara aprovimit, (iii) kërkon që të gjithë projektet kryesore të kontraktohen përmes tenderit konkurrencial dhe të hapur	Të gjitha ndër to aplikohen, (i) qeveria në mënyrë të rregullt publikon vlerën e të gjithë detyrimeve totale pjesë e projekteve të investimeve disa vjeçare, (ii) bën subjekt të analizës kosto përfitim të gjithë projektet madhore përpara aprovimit, (iii) kërkon që të gjithë projektet kryesore të kontraktohen përmes tenderit konkurrencial dhe të hapur
2.2	Kuadri Ligjor	<i>Fuqia dhe përgjegjësia e degëve ekzekutive dhe legjislative të qeverisë në procesin e buxhetimit duhet të përcaktohet me ligj, buxheti duhet të prezantohet, debatohet dhe të aprovohet duke lënë kohë të përshtatshme</i>			
2.2.1	Legjislacioni fiskal	Kuadri ligjor përcakton qartë orarin e përgatitjes dhe miratimit të buxhetit, përmbajtjet e rëndësishme për dokumentimin e buxhetit, si dhe fuqitë dhe përgjegjësitë për ekzekutivin dhe legjislativin në procesin e buxhetimit.	Kuadri ligjor përcakton një nga të mëposhtmet, (i) orarin për përgatitjen dhe aprovimin e buxhetit, (ii)kërkesat kryesore të përmbajtjes për buxhetin e propozuar të ekzekutivit, ose (iii) fuqine e legjislativit për të amenduar buxhetin e propozuar të ekzekutivit	Kuadri ligjor përcakton dy nga të mëposhtmet, (i) orarin për përgatitjen dhe aprovimin e buxhetit, (ii)kërkesat kryesore të përmbajtjes për buxhetin e propozuar të ekzekutivit, ose (iii) fuqine e legjislativit për të amenduar buxhetin e propozuar të ekzekutivit	Kuadri ligjor përcakton të gjitha nga të mëposhtmet, (i) orarin për përgatitjen dhe aprovimin e buxhetit, (ii)kërkesat kryesore të përmbajtjes për buxhetin e propozuar të ekzekutivit, ose (iii) fuqine e legjislativit për të amenduar buxhetin e propozuar të ekzekutivit

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
2.2.2	Përshtatshmëria në Kohë e Dokumentave të Buxhetit	Ligjvënësve dhe publikut, në mënyrë të vazhdueshme, i lihet kohë e përshtatshme për të vëzhguar me imtësi dhe për të aprovuar buxhetin vjetor	Buxheti i vihet në dispozicion ligjvënësit dhe bëhet i disponueshëm publikut të paktën një muaj përpara fillimit të vitit financiar dhe aprovohet dhe publikohet deri në një muaj pas fillimit të vitit financiar	Buxheti i vihet në dispozicion ligjvënësit dhe bëhet i disponueshëm publikut të paktën dy muaj përpara fillimit të vitit financiar dhe aprovohet dhe publikohet afër fillimit të vitit financiar	Buxheti i vihet në dispozicion ligjvënësit dhe bëhet i disponueshëm publikut të paktën tre muaj përpara fillimit të vitit financiar dhe aprovohet dhe publikohet deri në një muaj përpara fillimit të vitit financiar
2.3	Orientimi i Politikave	Parashikimet dhe buxhetet fiskale duhet të prezantohen në një mënyrë që të lehtësojë analizën dhe llogaridhënien e vlerësimit të politikave			
2.3.1	Objektivat e Politikave Fiskale	Qeveria shprehet dhe raporton me objektiva të qarta dhe të matshme për financat publike	Qeveria shprehet dhe raporton në mënyrë të rregullt për një objektiv numerike për agregatët fiskal kryesor i cili është ose preciz ose i mjaftueshëm në kohë	Qeveria shprehet dhe raporton në mënyrë të rregullt për një objektiv numerike për agregatët fiskal kryesor i cili është edhe preciz edhe i mjaftueshëm në kohë	Qeveria shprehet dhe raporton në mënyrë të rregullt për një objektiv numerike për agregatët fiskal kryesor i cili është edhe preciz edhe i mjaftueshëm në kohë dhe është vendosur për 3 ose më shumë vite

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
2.3.2	Informacioni mbi Performancën	Dokumentimi mbi buxhetet siguron informacion përsa i përket objektivave dhe rezultateve të arritura sipas secilës nga zonat e politikave kryesore qeveritare	Dokumentimi i buxhetit përfshin informacion mbi inputet e kërkuara nga secila fushë kryesore e politikave qeveritare	Dokumentimi i buxhetit raporton për objektivat për, dhe performancën ndaj, produktit që do të lëvrohet nga secila fushë kryesore e politikave qeveritare	Dokumentimi i buxhetit raporton për objektivat për, dhe performancën ndaj, rezultatit që duhet të arrihet nga secila fushë kryesore e politikave qeveritare
2.3.3	Pjesmarrja e Publikut	Qeveria i siguron publikut një përmbledhje të aksesueshme të pasojave të politikave të buxhetit dhe një mundësi për të marrë pjesë në përgatitjen e buxhetit	Qeveria publikon një përshkrim të aksesueshëm të performancës dhe perspektivës fiskale dhe ekonomike më të fundit, dhe gjithashtu një përmbledhje të ndikimit të buxhetit tek një qytetar tipik	Qeveria publikon një përshkrim të aksesueshëm të performancës dhe perspektivës fiskale dhe ekonomike më të fundit, dhe gjithashtu një përshkrim të detajuar të ndikimit të buxhetit tek një qytetar tipik, dhe i siguron qytetarët me një zë formal në përgatitjen e buxhetit	Qeveria publikon një përshkrim të aksesueshëm të performancës dhe perspektivës fiskale dhe ekonomike më të fundit, dhe gjithashtu një përshkrim të detajuar të ndikimit të buxhetit për grupe të ndryshme demografike, dhe i siguron qytetarët me një zë formal në përgatitjen e buxhetit
2.4	Kredibiliteti	Parashikimet fiskale dhe ekonomike dhe buxhetet duhet të jenë të besueshme			
2.4.1	Vlerësim i Pavarur	Parashikimet ekonomike dhe fiskale të qeverisë dhe performanca e saj janë subjekt i vlerësimit të pavarur	Dokumentimi i buxhetit përfshin krahasime mes projeksioneve fiskale dhe ekonomike të qeverisë dhe ato nga parashikuesit e pavarur	Një trupë e pavarur vlerëson besueshmërinë e parashikimeve fiskale dhe ekonomike të qeverisë	Një trupë e pavarur vlerëson besueshmërinë e parashikimeve fiskale dhe ekonomike të qeverisë, dhe performancën e saj ndaj objektivave të politikës fiskale
2.4.2	Buxheti Shtesë	Çdo ndryshim i rëndësishëm nga buxheti i aprovuar autorizohet nga legjislativi.	Një buxhet suplementar rregullon shpenzimet që kalojnë buxhetin e aprovuar	Një buxhet suplementar kërkohet përpara ndryshimeve të rëndësishme ndaj totalit të shpenzimeve të buxhetuara	Një buxhet suplementar kërkohet përpara ndryshimeve të rëndësishme ndaj totalit të shpenzimeve të buxhetuara apo të ndryshon thelbësisht përbërjen e tyre

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
2.4.3	Ripërshtatja e Parashikimeve	Dokumentimi i buxhetit dhe ndonjë ndryshim pasues duhet të shpjegojnë ndryshimet e rëndësishme nga parashikimi fiskal i mëparshëm i qeverisë, duke evidentuar ndikimin fiskal të politikave të reja nga parashikimi bazë	Diferencat mes arritjeve të njëpasnjëshme të të ardhurave, shpenzimeve dhe parashikimit financiar tregohen në nivel agregat, me një diskutim cilësor të impaktit të politikave të reja mbi parashikimet	Diferencat mes arritjeve të njëpasnjëshme të të ardhurave, shpenzimeve dhe parashikimit financiar zërthehen në efektin total të politikave të reja dhe përcaktorëve makroekonomik	Diferencat mes arritjeve të njëpasnjëshme të të ardhurave, shpenzimeve dhe parashikimit financiar zërthehen në ndryshimet e politikave individuale, përcaktorëve makroekonomik, dhe faktorëve të tjerë si rregullimeve kontabile dhe teknike
3	ANALIZA E RISKUT FISKAL DHE MENAXHIMI	Qeveritë duhet të bëjnë të ditur, të analizojnë dhe menaxhojnë riskun e financave publike dhe të sigurojnë koordinim efektiv të vendimarrjes fiskale për të gjithë sektorin publik			
3.1	Prezantimi i riskut dhe analizimi	Qeveritë duhet të publikojnë raporte përmbledhëse periodike mbi riskun e perspektivave fiskale.			
3.1.1	Risku makroekonomik	Qeveria raporton për atë se si rezultati fiskal mund të ndryshojë nga parashikimet e linjës bazë si pasojë e supozimeve makroekonomike.	Dokumentimi i buxhetit përfshin diskutimin mbi ndjeshmërinë e parashikimeve fiskale ndaj supozimeve makroekonomike kryesore	Dokumentimi i buxhetit përfshin analizën e ndjeshmërisë dhe skenarët alternativë të parashikimit makroekonomik dhe fiskal	Dokumentimi i buxhetit përfshin analizën e ndjeshmërisë, skenarët alternativë, dhe parashikimet probabilistikë të rezultatit fiskal
3.1.2	Risku fiskal specifik	Qeveria siguron një raport përmbledhës periodik mbi riskun specifik të parashikimeve të saj fiskale	Risqet specifike kryesore të parashikimit fiskal paraqiten në një raport përmbledhës dhe diskutohen në terma sasiorë	Risqet specifike kryesore të parashikimit fiskal paraqiten në një raport përmbledhës, së bashku me vlerësues të madhësisë së tyre	Risqet kryesore specifike në parashikimin fiskal paraqiten në një raport përmbledhës, së bashku me vlerësimin e madhësisë së tyre dhe, ku janë të praktikueshëm, gjasat e tyre

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
3.1.3	Analiza e Qëndrueshmërisë Fiskale Afatgjatë	Qeveria publikon periodikisht projeksionin e evolucionit të financave publike për periudhën afatgjatë.	Qeveria në mënyrë të rregullt publikon projeksionet e qëndrueshmërisë të agregateve kryesorë fiskal dhe fondeve të sigurimit shoqëror dhe shëndetsor	Qeveria në mënyrë të rregullt publikon skenare të shumtë të qëndrueshmërisë të agregateve kryesorë fiskal dhe fondeve të sigurimit shoqëror dhe shëndetsor për të paktën mbi 30 vitet e ardhshme duke përdorur një rang supozimesh makroekonomike	Qeveria në mënyrë të rregullt publikon skenare të shumtë të qëndrueshmërisë të agregateve kryesorë fiskal dhe fondeve të sigurimit shoqëror dhe shëndetsor për mbi 30 vitet e ardhshme duke përdorur një rang supozimesh makroekonomike, demografike, burimesh natyrore dhe ndonjë supozimi tjetër
3.2	Menaxhimi i riskut	Qeveritë duhet të publikojnë raporte përmblledhëse periodike mbi riskun e perspektivave fiskale.			
3.2.1	Provizionet buzhetore	Buxheti ka alokime transparente dhe të përshtatshme për fonde provizioni që evidentohen përgjatë ekzekutimit të buxhetit	Buxheti përfshin një alokim për fondet për provizione	Buxheti përfshin një alokim për fondet për provizione me një kriter aksesimi transparent	Buxheti përfshin një alokim për fondet për provizione me një kriter aksesimi transparent dhe raportim të rregullt vjetor mbi përdorimin e tyre
3.2.2	Menaxhimi i Aseteve dhe i Detyrimeve	Risqet në lidhje me asetet dhe detyrimet paraqiten dhe menaxhohen	E gjithë huamarrja autorizohet me ligj dhe risku që përbën borxhin qeveritar analizohet dhe paraqitet	E gjithë huamarrja autorizohet me ligj dhe risku që përbën borxhin dhe astete financiare qeveritare analizohen dhe paraqiten	Të gjithë detyrimet dhe blerjet apo zotërimet e asetëve kryesore autorizohen me ligj, dhe risku që lidhet me bilancin financiar paraqitet dhe menaxhohet sipas një strategjie të publikuar
3.2.3	Garancitë	Garancitë për ekspozimin ndaj riskut të qeverisë paraqiten në mënyrë të rregullt dhe autorizohen me ligj	Të gjithë garancitë qeveritare, përfituesit e tyre dhe ekspozimi bruto i krijuar nga to publikohet të paktën një herë në vit.	Të gjithë garancitë qeveritare, përfituesit e tyre dhe ekspozimi bruto i krijuar nga to publikohet të paktën një herë në vit. Vlera maksimum e garancive ose e stokut të tyre autorizohet me ligj	Të gjithë garancitë qeveritare, përfituesit dhe ekspozimi bruto i krijuar nga to dhe probabiliteti i shuarjes së tyre publikohet të paktën një herë në vit. Vlera maksimum e garancive ose e stokut të tyre

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
3.2.4	Partneriteti Publik Privat	Detyrimet për partneritetin publik privat paraqiten në mënyrë të rregullt dhe menaxhohen aktivisht	Qeveria të paktën një herë në vit publikon të drejtat e saj totale, detyrimet dhe vlera të tjera jashtë tyre pjesë e kontratave të bashkëpunimit privat publik	Qeveria të paktën një herë në vit publikon të drejtat e saj totale, detyrimet dhe vlera të tjera jashtë tyre pjesë e kontratave të bashkëpunimit privat publik dhe arkëtimet dhe pagesat e pritura vjetore përgjatë jetës së kontrateve	Qeveria të paktën një herë në vit publikon të drejtat e saj totale, detyrimet dhe vlera të tjera jashtë tyre pjesë e kontratave të bashkëpunimit privat publik dhe arkëtimet dhe pagesat e pritura vjetore përgjatë jetës së kontrateve. Një limit ligjor vendoset mbi akumulimin e obligacioneve
3.2.5	Ekspozimi i Sektorit Financiar	Ekspozimi fiskal potencial i qeverisë ndaj sektorit financiar analizohet, paraqitet dhe menaxhohet	Autoritetet kuantifikojnë dhe paraqesin të paktën një herë në vit mbështetjen e tyre eksplicite ndaj sektorit financiar	Autoritetet kuantifikojnë dhe paraqesin të paktën një herë në vit mbështetjen e tyre eksplicite ndaj sektorit financiar dhe në mënyrë të rregullt ndërmarrin një vlerësim të stabilitetit të sektorit financiar	Autoritetet kuantifikojnë dhe paraqesin të paktën një herë në vit mbështetjen e tyre eksplicite ndaj sektorit financiar dhe në mënyrë të rregullt ndërmarrin një vlerësim të stabilitetit të sektorit financiar bazuar në një rang skenarësh të tregut financiar dhe makroekonomik
3.2.6	Burimet natyrore	Interesat e qeverisë në asetet e burimeve natyrore të konsumueshme dhe shfrytëzimi i tyre vlerësohet, paraqitet dhe menaxhohet	Qeveria publikon vlerësimin vjetor të volumit dhe vlerës të asetëve të burimeve natyrore më kryesore, po ashtu dhe volumin dhe vlerën e shitjeve të vitit të mëparshëm dhe të ardhurat fiskale	Qeveria publikon vlerësimin vjetor të volumit dhe vlerës të asetëve të burimeve natyrore më kryesore me disa skenare çmimesh, po ashtu dhe volumin dhe vlerën e shitjeve të vitit të mëparshëm dhe të ardhurat fiskale	Qeveria publikon vlerësimin vjetor të volumit dhe vlerës të asetëve të burimeve natyrore më kryesore me disa skenare çmimesh dhe nxjerrësh, po ashtu dhe volumin dhe vlerën e shitjeve të vitit të mëparshëm dhe të ardhurat fiskale

#	DIMENSIONI	PRINCIPI	PRAKTIKAT		
			BAZIKE	E MIRË	E AVANCUAR
3.2.7	Risku i Mjedisit	Ekspozimi fiskal potencial ndaj katastrofave natyrore dhe risqe të tjera kryesore të mjedisit vlerësohen, paraqiten dhe menaxhohen	Qeveria identifikon dhe diskuton riskun fiskal kryesor nga katastrofat natyrore në terma sasiorë	Qeveria identifikon dhe diskuton riskun fiskal kryesor nga katastrofat natyrore , duke i kuantifikaur ato mbi bazën e eksperiencave historike	Qeveria identifikon dhe diskuton riskun fiskal kryesor nga katastrofat natyrore , duke i kuantifikaur ato mbi bazën e eksperiencave historike, dhe i menaxhon ato sipas një strategjie të publikuar
3.3	<i>Koordinimi fiskal</i>	<i>Relacionet dhe performanca fiskale të sektorit publik duhet të analizohen, paraqiten dhe të koordinohen.</i>			
3.3.1	Njësitë nënqeveritare	Informacioni gjithëpërfshirës mbi kushtet financiare dhe performancën e njësive nënqeveritare, në mënyrë individuale dhe si sektor i konsoliduar, koleksionohen dhe publikohen	Kushtet financiare dhe performanca e njësive nënqeveritare publikohet në mënyrë vjetore	Kushtet financiare dhe performanca e njësive nënqeveritare publikohet në mënyrë vjetore dhe ka një limit të huamarrjes dhe detyrimeve të tyre	Kushtet financiare dhe performanca e njësive nënqeveritare publikohet në mënyrë katërmujore dhe ka një limit të huamarrjes dhe detyrimeve të tyre
3.3.2	Korporatat publike	Qeveria në mënyrë të rregullt publikon informacion gjithëpërfshirës mbi performancën financiare të korporatave publike, duke përfshirë dhe ndonjë aktivitet gati – fiskal të ndërmarrë nga ato	Të gjithë transfertat mes qeverisë dhe korporatave publike paraqiten të paktën një herë në vit	Të gjithë transfertat mes qeverisë dhe korporatave publike paraqiten, dhe bazohen në një politikë bashkëpunimi të publikuar, një raport të përgjithshëm mbi performancën financiare të sektorit të korporatave publike, publikohet të paktën një herë në vit	E gjithë mbështejta direkte dhe indirekte mes qeverisë dhe korporatave publike paraqiten, dhe bazohen në një politikë bashkëpunimi të publikuar. Një raport i përgjithshëm mbi performancën të sektorit të korporatave publike, që përfshin vlersimet të ndonjë aktiviteti gati fiskal të ndërmarrë, publikohet të paktën një herë në vit

AUDITIMI I TË ARDHURAVE PUBLIKE

Konkluzione dhe Rekomandime

(2 Qershor 2005)

Hyrje

Kongresi i VI EUROSAL i mbajtur në Bon nga data 30 maj - 2 qershor 2005, trajtoi Auditimin e të Ardhurave publike nga SAI-t. Marrja dhe ruajtja e një baze të mirë të të ardhurave është e një rëndësie themelore për një politikë-bërje të efektshme qeveritare. Duke pasur parasysh rëndësinë e një sistemi efektiv grumbullimi të të ardhurave, SAI-t kanë zhvilluar auditimin e të ardhurave brenda një fushe specifike dhe teknike të punës së tyre audituese. Në qendër të vëmendjes së diskutimeve të Kongresit, ishin tre nën-temat e mëposhtme:

Nën-tema 1 Rëndësia e të ardhurave publike për menaxherët financiarë publikë dhe për autoritetin buxhetor Legjislativ

Nën-tema 2 Roli i SAI-t në ciklin buxhetor

Nën-tema 3 Metodat e auditimit dhe ndikimi i auditimit

Tre grupe pune ndërkombëtare të SAI-ve të kryesuar nga Holanda (nën-tema 1), Mbretëria e Bashkuar (Nën-tema 2) dhe Polonia (Nën-tema 3), përgatitën materialet e Kongresit.

Ata hartuan materiale për diskutim për tre Nën-temat duke përmbledhur gjetjet dhe mësimet e nxjerra nga 47 anëtarët aktualë të EUROSAL-t. Duke kontribuar me materiale të detajuara, anëtarët e EUROSAL-t ndihmuan në dhënien e një baze të gjerë informacioni dhe eksperiencash për diskutimet e Kongresit. Duke bërë këtë, ata

hodhën themelet për të prodhuar gjetjet kryesore, konkluzionet dhe rekomandimet e zhvilluara nga Kongresi në rrjedhën e diskutimeve të tij në Petersberg, pranë Bonit. Kongresi vazhdoi kështu, bashkëpunimin miqësor që ka ekzistuar tashmë në mesin e anëtarëve të EUROSAI-së për 15 vjet dhe që ka për qëllim shkëmbimin e informacionit, opinioneve dhe mësimëve të nxjerra. Në ndjekje të këtyre objektivave, përfundimet dhe rekomandimet e paraqitura më poshtë shërbejnë për të rritur më tej aftësitë teknike, bashkëpunimin dhe misionin e performancës së anëtarëve të EUROSAI-t në auditimin e të ardhurave publike. Këto bëjnë të mundur kuadrin e shumëllojshëm në të cilin anëtarët e EUROSAI-t zhvillojnë funksionet e tyre, duke u kushtuar vëmendje mandateve individuale të SAI-ve.

1. Rëndësia e të Ardhurave Publike për Menaxherët Financiarë Publikë dhe për Autoritetin buxhetor Legjislativ

1.1. Kompetencat e SAI-ve për të audituar të gjitha veprimet financiare publike janë theksuar në Deklaratën e Limës të miratuar në vitin 1977. Për sa i përket të ardhurave tatimore, Deklarata bën thirrje që ato të auditohen sa më gjerësisht të jetë e mundur. Parimet dhe standardet e përcaktuara në Deklaratë aplikohen njësoj si për shpenzimet publike, ashtu edhe për të ardhurat publike. EUROSAL përsërit angazhimin e tij ndaj Deklaratës së Limës, Magna Carta e auditimit të qeverisë, e cila ende ofron një kuadër të përshtatshëm normativ për auditimin e të ardhurave buxhetore nga SAI-t.

1.2. Ndonëse Deklarata në mënyrë të qartë i referohet tatimit, aspektet e mëposhtme janë gjithashtu të zbatueshme për të gjitha të ardhurat publike:

- theksi në kryerjen e auditimeve të ligjshmërisë dhe të rregullshmërisë të mbledhjes së të ardhurave publike,
- rëndësia e të shqyrtuarit gjithashtu të eficiencës të sistemit të mbledhjes së të ardhurave kur auditohet mbledhja e të ardhurave,
- nevoja për të rishikuar arritjen e objektivave për të ardhurat dhe
- rëndësia e propozimit të përmirësimeve në organet legjislative.

1.3 Poshtë nivelit të Deklaratës së Limës, ka disa udhëzues specifikë të auditimit për llojet e veçanta të të ardhurave publike (p.sh. TVSH). Për këtë arsye, Kongresi mirëpret inisiativa nga anëtarët e EUROSAL-t apo grupet e punës Europiane, të cilët tashmë kanë udhëzime të tilla për t'i ndarë ato me SAI të tjerë.

1.4 EUROSAL njeh se tatimet dhe kontributet shoqërore janë kategoria më e rëndësishme e të ardhurave publike. Ka pasur pak ndryshim me kalimin e viteve në përbërjen e të ardhurave publike. Raportimi nga autoritetet tatimore mbi

informacione jo-financiare, është i rrallë. Kjo duhet të inkurajohet në interes të transparencës.

1.5 Ndërsa përbërja e të ardhurave publike është mjaft e qëndrueshme, EUROSAI sheh se proceset e mbledhjes së tyre, po ndryshojnë me shpejtësi për shkak të legjislacionit të ri, riorganizimit të administratave tatimore dhe rritjes së automatizimit. SAI-t synojnë t'i marrin parasysh këto ndryshime kur përgatisin strategjitë e auditimeve të tyre. Në zhvillimin e strategjive të tyre të auditimit, SAI-t, duhet gjithashtu të jenë të ndjeshëm ndaj kontekstit më të gjerë të auditimit, duke përfshirë kulturën e taksave dhe gatishmërinë e publikut për të përmbushur kërkesat e pagesës së taksave. Kjo e fundit ka një ndikim të fortë mbi strategjinë dhe organizimin e administratës tatimore.

1.6 Të ballafaquar me burime të kufizuara, SAI-t duhet të shikojnë për një shpërndarje eficiente të kapaciteteve të tyre ekzistuese. Zhvillimi i një strategjie të veçantë për auditimin e të ardhurave publike, brenda të cilës analiza e riskut luan një rol të rëndësishëm, është një hap i rëndësishëm në drejtim të optimizimit të punës së tyre audituese. Mbi të gjitha, kjo prek taksat, si burimi kryesor i të ardhurave publike dhe në rastin më të keq, ka të bëjë me një humbje të madhe në të ardhura. Tregues të rëndësishëm për analizën e riskut të SAI-ve në fushën e aktiviteteve të auditimit tatimor, janë:

- volumi i të ardhurave të gjeneruara nga një lloj i veçantë tatimi,
- kompleksiteti dhe efektiviteti i rregulloreve të zbatueshme tatimore,
- gabimet në mbledhjen e taksave,
- forca e strategjisë së auditimit dhe proceseve të kontrollit të brendshëm brenda organeve tatimore,
- mundësia e tatimpaguesve që të shmangin taksat ose të kryejnë evazion të detyrimit tatimor,

- mundësia e të paturit të të drejtave për të kontaktuar me autoritetet lidhur me të dhënat tatimore,
- proceset e ristrukturimit dhe modernizimit.

1.7 Analiza e materialeve të paraqitura nga anëtarët e EUROSAL -së ka treguar një numër rastesh të fluksit monetar, që duke folur në mënyrë rigoroze, ka natyrën e shpenzimeve të transferuara në buxhetet nga të ardhurat, veçanërisht në formën e subvencioneve tatimore. Skemat e ndihmës tatimore të këtij lloji, kanë arritur një madhësi të konsiderueshme në disa vende. Megjithatë, deri tani nuk ka një thellim të mjaftueshëm mbi efektivitetin e subvencioneve tatimore. SAI-t duhet të japin gjetje më të besueshme rreth volumit dhe arritjes së objektivave mbi subvencionet tatimore. Disa materiale, vunë në dukje shtrirjen dhe kompleksitetin e legjislacionit tatimor, që mund të çojë në mungesa dhe përjashtime tatimore. Për këtë, Kongresi miraton kryerjen e një auditimi të koordinuar të subvencioneve tatimore, i hapur për të gjithë anëtarët EUROSAL.

2. Roli i SAI-t në Ciklin Buxhetor

2.1 Vlerësimet mbi të ardhurat të përgatitura nga dega e ekzekutivit kanë një ndikim të konsiderueshëm në vendim-marrjen parlamentare. SAI-t njohin rritjen e interesit të jashtëm në të qenit e tyre më shumë të përfshirë në procesin e buxhetit të të ardhurave. Në këtë drejtim, SAI ka një pozicion veçanërisht të privilegjuar, të pavarur dhe të rëndësishëm në lidhje me të dhënat e të ardhurave të buxhetit të qeverisë, supozimet dhe parashikimet. Në të vërtetë, SAI mund të jetë i vetmi organ me qasje të pavarur ndaj këtyre të dhënave të detajuara. Por, nuk është roli i SAI-t të formulojë parashikime mbi të ardhurat, mbi të cilat bazohen buxhetet.

2.2 Në pajtim me Deklaratën e Limës, SAI-t duhet megjithatë, të kryejnë analiza të mëpasme të vlerësimeve mbi të ardhurat, duke i inkurajuar parashikime të arsyeshme të të ardhurave. Pritshmëritë e Parlamenteve për SAI-t, të disa qeverive dhe të publikut, në pjesën më të madhe po ndryshojnë dhe rriten. Nëse këto pritshmëri zhvillohen më tej, siç mund të ndodhë, SAI-t duhet të jenë të kujdesshëm për të mos u detyruar të marrin masa që do të ulnin kapacitetin e tyre për të vepruar si auditues të jashtëm efektive dhe të pavarur. Megjithatë, refuzimi për ndryshim gjithashtu bart riskun për të zvogëluar qëndrueshmërinë dhe respektin që ata kanë. Prandaj është e rëndësishme për çdo SAI, që të punojnë lidhur me strategjitë e tyre për të ardhmen.

2.3 Para se të ndërmerret ndonjë punë lidhur me buxhetin për të ardhurat, një SAI duhet të ketë kompetencë ligjore për të kryer këtë punë. Por, SAI-t gjithashtu duhet të sigurojnë aftësitë e nevojshme teknike dhe burimet. Megjithatë, vlerësimet mbi të ardhurat bazohen në parashikimet e tendencave të përgjithshme ekonomike dhe mbi objektivat e politikës, të dyja këto bartin riskun e lartë të gabimit. SAI-t duhet t'i njohin këto kufizime dhe të pranojnë se për ta mund të jetë shumë e vështirë për të

gjetur prova të mjaftueshme, të rëndësishme dhe të besueshme në mbështetje të vlerësimit të buxhetit të të ardhurave si dhe parashikimeve.

2.4 Si pjesë e funksionit të analizës së tyre buxhetore, shumë SAI janë të autorizuar për të ofruar ekspertizë për çështjet që lidhen me vlerësimin e të ardhurave nga taksat dhe të ardhurat e tjera publike. SAI-t mund të dëshirojnë të shohin metodat e llogaritjes dhe procedurat e vendim-marrjes nëpërmjet të cilave parashikimet mbi buxhetet e të ardhurave zhvillohen. SAI-t mund të identifikojnë dobësitë në metodologjinë e vlerësimit dhe të nxjerrin në pah mënyra të përmirësimit të parashikimeve të buxheteve. Duke bërë kështu, SAI-t do të japin një kontribut të madh në përmirësimin e cilësisë së parashikimeve të vlerësimeve të ardhshme të të ardhurave dhe do të përmirësojnë transparencën e aprovimeve buxhetore. Prandaj, SAI-t duhet, kur është e mundur, të ndërmarrin auditime që kanë për qëllim rritjen e transparencës së të dhënave, modeleve fiskale, metodologjive dhe proceseve për hartimin e parashikimeve dhe të buxheteve të të ardhurave.

2.5 Shkalla e përfshirjes së SAI-ve në rishikim e përgatitjes së buxhetit, ndryshon jashtëzakonisht. Disa SAI ndërmarrin ex-post auditime formale, që çojnë në opinione që lidhen me buxhetet e të ardhurave. Disa SAI gjithashtu, kryejnë auditimin e vlerësimit buxhetor dhe ofrojnë këshilla për qeveritë dhe parlamentet në fushën e të ardhurave. Kjo mundëson që qeveritë dhe parlamentet të përzgjedhin vlerësimet buxhetore sipas këtyre mësimave të nxjerra nga ushtrimi i auditimeve të mëparshme.

2.6 Në vendet ku deri më tani SAI-t nuk janë autorizuar për të luajtur ndonjë rol këshillues mbi buxhetet e të ardhurave në rrjedhën e procesit të buxhetit, mund të jetë e dëshirueshme që SAI-t të zgjerojnë mandatin e tyre lidhur me këtë. SAI-t pranojnë se në shumë zona nuk ka të dhëna të mira për të mbështetur punën audituese mbi buxhetet e të ardhurave. Disa vende kanë regjistrime më të mira të të dhënave makro-ekonomike se të tjerë. Kur ka të dhëna të mjaftueshme dhe me cilësi, SAI-t duhet të marrin parasysh rastin për auditimin e arsyeshmërisë së

supozimeve të të ardhurave buxhetore. Në këtë sipërmarrje, SAI-t mund të marrin parasysh edhe standartet e nxjerra nga IFAC.

2.7 Një pikë e rëndësishme e auditimit të të ardhurave është ekzekutimi i legjislacionit tatimor. Auditimi i të ardhurave nga SAI përqëndrohet në rastin kur autoriteti kompetent zbaton legjislacionin mbi të ardhurat dhe i mbledh këto të ardhura në kohë, plotësisht dhe në mënyrë të barabartë. Në kryerjen e kësaj pune, SAI-t mbështeten në dispozitat e aplikueshme të legjislacionit të të ardhurave dhe vlerësojnë në praktikë ndikimin e tyre. Misione të tilla auditimi mund të zbulojnë se rezultatet e veprimtarive administrative nuk janë në përputhje me objektivat e legjislacionit të miratuar.

2.8 Kur SAI-t identifikojnë devijime të tilla, ato jo gjithmonë i atribuohen vetëm mangësive administrative. Më saktë, devijimet mund të rezultojnë nga vetë dispozitat ligjore, për shembull, në qoftë se legjislacioni është tepër kompleks dhe për këtë arsye i vështirë për t'u zbatuar. Në ato raste, audituesit e jashtëm nuk duhet të kufizojnë veten për të vlerësuar operacionet qeveritare. Kur mandati i SAI-t lejon përfshirje të mëtejshme, SAI-t duhet të përdorin gjetjet e duhura të auditimit dhe konkluzionet e dala në këtë fushë për t'i dhënë këshilla ligjvënësit duke vënë në dukje mangësitë në ekzekutimin e dispozitave ligjore të pa zbatueshme dhe duke rekomanduar ndryshime legjislative. Kjo vlen edhe për rastet lidhur me mangësi në burime njerëzore dhe materiale.

3. Metodatat e Auditimit dhe Ndikimi i Auditimit

3.1 Në bazë të mandateve të tyre përkatëse, SAI-t mund të përdorin metodologji të ndryshme për auditimin e të ardhurave. Auditimet e rregullshmërisë dhe të përputhshmërisë janë të rëndësishëm sepse mund të tregojnë mbi mangësitë në zbatimin e legjislacionit të të ardhurave dhe trajtimin e pa barabartë lidhur me mbledhjen e taksave. Auditimet e performancës në fushën e të ardhurave mund të jenë një mjet i përshtatshëm, p.sh. për të inkurajuar rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave dhe për të monitoruar proceset ristrukturuese brenda autoriteteve tatimore. Duke kombinuar rezultatet nga të dy llojet e auditimit, apo edhe duke kombinuar ndonjëherë metodat financiare me ato të performancës në një projekt të vetëm, mund të rritet plotësia e rezultateve dhe gjetjeve brenda auditimit të të ardhurave. Përveç kësaj, këto mund të jenë të dobishëm për vlerësimin e tatimit mbi efektivitetin e subvencioneve, duke hapur rrugën për verifikimin e arritjes së objektivave.

3.2 SAI-t duhet të aplikojnë të gjithë setin e elementeve të përcaktuara në Deklaratën e Limës me kryerjen e auditimeve të rregullshmërisë dhe performancës dhe duke kombinuar kriteret dhe metodat e auditimeve të mësipërme. SAI –t duhet t'i auditojnë të ardhurat sa më kuptueshëm të jetë e mundur dhe të përdorin mundësinë e thënë në Deklaratën e Limës për mundësinë e hyrjes në dosje të veçanta tatimore.

3.3 SAI-t duhet t'i shpërndajnë burimet e tyre me eficiencë dhe efektivitet në bazë të analizave të riskut dhe të përshtatin punën e tyre audituese mbi taksat në mjedise gjithnjë e më të kompjuterizuar. Për ta bërë këtë, janë të nevojshme kapacitetet për shkëmbimin e të dhënave me administratën fiskale dhe SAI-t kanë nevojë të informohen në një hap me sistemet e teknologjisë së informacionit të përdorura nga organet tatimore që do të auditohen. Mund të jetë e këshillueshme mbështetja tek

një ekspert i jashtëm, nëse SAI-t duhet të vlerësojnë përdorimin e programeve kompjuterike të ndërlikuara brenda organeve tatimore, si pjesë e punës së tyre audituese. Përveç kësaj, mund të jetë e dobishme për SAI-t, të zhvillojnë programet e veta kompjuterike për qëllime të auditimit.

3.4 SAI-t duhet të ndjekin zbatimin e rekomandimeve të tyre për adresimin e problemeve të deklaruara dhe rritjen e veprimeve të qeverisë. Në mënyrë që të sigurohet ndikimi i duhur i auditimit, auditime të mëpasshme duhet të kryhen, të paktën në ato raste me rrezik të lartë të humbjeve nga të ardhurat.

3.5 Në nivel kombëtar, SAI-t duhet të kërkojnë të bashkëpunojnë ngushtë dhe në një mënyrë të mirë-strukturuar me organe të tjera publike përgjegjëse për auditimin e të ardhurave. Për detyrat e veta të auditimit, SAI-t duhet të mbështeten sa më shumë në gjetjet e bëra nga organe të tjera. Partnerët e këtij bashkëpunimi mund të jenë organe të jashtme auditimi të niveleve të tjera qeverisëse dhe shërbime të brendshme auditimi që i përkasin degës ekzekutive.

3.6 Ndërvarësia në rritje e ekonomive kombëtare ka çuar në një situatë ku SAI-t në një farë mase, mund të mos jenë në gjendje për të kryer punën e tyre të auditimit të të ardhurave në mënyrë efektive, nëse nuk bashkëpunojnë me SAI të tjerë. Një shembull për këtë, është auditimi i organizuar ndërkombëtar i mashtrimit nga taksat, që shkakton humbje substanciale të të ardhurave në shumë vende. Bashkëpunimi ndërkombëtar i autoriteteve përgjegjëse është i nevojshëm për të luftuar këtë lloj të krimi. SAI-t që kryejnë misionet auditimi në këtë fushë duhet të jenë të përkushtuar për të punuar më ngushtë me SAI të tjerë. Kur një kuadër ligjor për të tilla bashkëpunime , p.sh. për shkëmbimin e të dhënave ndërkombëtare mungon, SAI mund t'i bëjnë thirrje parlamenteve të tyre për të përcaktuar kuadrin e nevojshëm përkatës.

4. Rekomandime të përgjithshme

Kongresi i VI i EUROSAT-t, mori në konsideratë në mënyrë të detajuar një gamë çështjesh të rëndësishme dhe komplekse. Këto të gjitha ndikojnë në rolin dhe punën e SAI-ve dhe kontributit që SAI-t mund të japin për transparencë më të mirë dhe për auditimin e të ardhurave publike. Bazuar në diskutimet e tij, Kongresi ra dakord që:

- anëtarët e EUROSAT-t të inkurajohen që të rivlerësojnë strategjitë e tyre të përgjithshme për auditimin e të ardhurave,
- duhet të ketë një auditim të koordinuar të subvencioneve të taksave që është i hapur për të gjithë anëtarët EUROSAT-t,
- oferta e grupit të punës për IT të EUROSAT-t për të shqyrtuar dhe raportuar mbi rëndësinë e IT në auditimin e mashtrimit me të ardhurat publike të pranohet,
- anëtarët e EUROSAT-t duhet të inkurajohen për të shkëmbyer informacionin mbi standartet, përkufizimet dhe kriteret për t'ju mundësuar atyre krahasimin ndërkombëtarisht të kostove dhe performancës së administratave tatimore,
- anëtarët e EUROSAT-t duhet të inkurajohen për të shkëmbyer iniciativat e tyre dhe udhëzimet përkatëse në temën e të ardhurave publike nëpërmjet faqes zyrtare të EUROSAT-t.

Kongresi gjithashtu ka kërkuar që për pikat e mësipërme, raportet të jenë gati për Kongresin e VII të EUROSAT-t, në vitin 2008.

Seria : botime KLSH - 11/2014/32

ISBN: 978-9928-159-24-3



Kontrolli i Lartë i Shtetit
Bulevardi " Dëshmorët e Kombit", nr. 3,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: klsh@klsh.org.al